

Shënim i  
Seancave Pleurore  
13/10/2021



**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
*Deputet*



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

**Lënda:** Nismë për miratimin e projektligjit “Për Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Zonjës Lindita Nikolla  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

**E nderuar Zonja Kryetare,**

Bazuar në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës të Republikën së Shqipërisë dhe nenit 68, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikën së Shqipërisë, Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin “Për Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të deputetit, Ismet Beqiraj.

**Bashkëlidhur:**

*Projektligji “Për Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik në Republikës e Shqipërisë”,  
Relacioni Shpjegues i Projektligjit,  
Tabelë referencë,*

Ismet Beqiraj  
*[Signature]*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**PËR URDHRIN E INXHINIERIT HIDROTEKNIK**  
**NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 68, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me propozim të një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**VENDOSI:**

**KREU I**

<sup>1</sup>Ky ligj është përafëruar plotësisht me:

-Directive 2005/36/EC of the European Parliament and of the Council of 7 September 2005 on the recognition of professional qualifications, OJ L 255, 30.9.2005, as amended by Directive 2013/55/EU of the European Parliament and of the Council of 20 November 2013 amending Directive 2005/36/EC on the recognition of professional qualifications and Regulation (EU) No 1024/2012 on administrative cooperation through the Internal Market Information System ('the IMI Regulation') OJ L 354, 28.12.2013

-Communication from the Commission to the European Parliament, the Council and the European Economic and Social Committee on Evaluating national regulations on access to professions COM (2013)676.

-Mutual evaluation of regulated professions overview of the regulatory framework in the construction sector by using the example of civil engineers. Report based on information transmitted by Member States and on the meeting of 30 September 2014. Ref. Ares (2015)3956612 - 25/09/2015

- Direktivën e Këshillit 2008/114/KE, datë 8.12.2008, "Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike europiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre". Numri CELEX 32008L0114, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 345/75, datë 23.12.2008, faqe 75-82.

- Direktivën 2007/60/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23.10.2007, "Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmytjeve", numri CELEX 32007L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 288/27, datë 6.11.2007, faqe 27-34.

## DISPOZITA TË PERGJITHËSHME

### Neni 1

#### **Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe forcimin e autoritetit publik të profesionit të inxhinierit hidroteknik, përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e këtij profesioni, rregullimin e edukimit profesional të inxhinierit hidroteknik, garantimin e standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, të sigurisë, të shëndetit, të zhvillimit ekonomik, si edhe të aftësisë për reagimin emergjent, duke respektuar parimin e krijimtarsisë dhe shqyrtimit të pavarur, si dhe të autonomisë së profesionit të inxhinierit hidroteknik.

### Neni 2

#### **Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimin i rregullave të organizimit dhe të veprimtarsisë së Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, si dhe marrëdhëniet juridike e etiko-profesionale të profesionistëve hidroteknik.

### Neni 3

#### **Misioni**

1. Misioni i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e hidroteknikës, si dhe mbrojtja e përfituesve të shërbimit dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të Inxhinierit Hidroteknik.
2. Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik ushtron këto kompetenca:
  - a) jep dhe heq liçencën/certifikatën individuale të ushtrimit të profesionit;
  - b) vendos standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për çdo inxhinier hidroteknik si edhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;
  - c) nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional dhe etik të anëtarëve të Urdhrit;
  - ç) rivlerëson periodikisht kompetencën dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit përballë standardeve të vendosura;
  - d) nxit dhe ndihmon për marrjen e masave, me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar nga ushtruesit e profesionit dhe mbrojtjen e përfituesit të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit;
  - dh) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, institucionet e tjera, akademike, shkencore dhe arsimore, për të siguruar standarde në edukimin e vazhdueshëm gjatë karrierës, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të Urdhrit;
  - e) angazhimin në veprimtari shërbimi për vlerësimin dhe ekspertizën teknike drejtpërdrejt të institucioneve financiare dhe siguruese, si institucion i vetëm në fushën e veprimtarsisë hidroteknike;
  - ë) mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik dhe menaxhon sistemin e

administrimit dhe përditësimit të tij;

f) krijon dhe mirëmban të përditësuar arkivën historike teknike e cila ka për qëllim regjistrimin dhe ruajtjen e informacionit për dokumentimin e projekteve të ndërtuara;

g) mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre e të profesionit të hidroteknikut;

gj) informon publikun, nëpërmjet faqes zyrtare të Urdhrit, për të gjitha aktet e miratuara nga organet e Urdhrit, të përcaktuara në këtë ligj.

#### Neni 4

#### Përkufizime

1. **"Aftësia"** është zotësia për të zbatuar njohuritë dhe dijet, në përmbushjen e detyrave e në zgjidhjen e problemeve. Aftësia mund të jetë njohëse, kur vë në përdorim mendimin logjik, intuitat dhe krijues, ose praktike kur vë në përdorim shkathtësinë manuale dhe përdorimin e metodave, materialeve, veglave e instrumenteve.

2. **"Asambleja"** është organ kolegjal vendimmarrës i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik dhe kryen funksionet sipas përcaktimeve të këtij ligji si edhe të statut-rregullores së Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik. Asambleje e ushtron veprimtarinë e saj ekzekutive vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale.

3. **"Autonomi Profesionale"**, të qenit i lirshëm nga rrethanat apo influencat që mund të komprometojnë kryerjen e shërbimit, të ruhet një gjykim profesional, si edhe sjellje e paanshme dhe e pa ndikuar;

4. **"Çertifikatë Profesionale"**, është dokument zyrtar që vërteton kryerjen e një trajnimi dhe që vërteton aftësinë e fituara gjatë edukimit profesional për të kryer një shërbim të ri dhe që lidhet me bazën e Hidroteknikës dhe anasjelltas.

5. **"Çertifikatë"** është dokumenti që vërteton të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën e veprimtarisë hidroteknike e lëshuar nga Urdhri Profesional i Inxhinierit Hidroteknik dhe nënshkruar nga vetë poseduesi.

6. **"Deontologjia"**, deontologjia hidroteknike, është një bashkësi parimesh dhe rregullash të cilat ekipi i inxhinierëve hidroteknik është i detyruar t'i zbatoj dhe të respektoj gjatë ushtrimit të profesionit të inxhinierit hidroteknik. Deontologjia në veprimtarinë hidroteknike siguron zbatimin e drejtë të profesionit të inxhinierit hidroteknik në shoqëri duke u orientuar nga morali, ligji dhe e drejta.

7. **"Dëshmi Profesionale"** është dokument i cili përmban të dhënat për kualifikimin pozicionin e punës, kohën dhe performancën e inxhinierëve dhe specialistëve plotësues.

8. **"Diplomë"** është dokument zyrtar që vërteton një fakt në këtë rast vërtetësinë e të pasurit një titull, në Republikën e Shqipërisë.

9. **"ECTS-European Credit Transfer System"**, është përcaktim i kreditit sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve të formimit në edukimin e lartë profesional.

10. **"Emertime"**, në funksion të klasifikimit pedagogjiko-shkencor apo kërkimor të personelit mësimdhënës dhe atij kërkimor në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe veprimtarinë e tyre shkencore, sipas legjislacionit në fuqi, emërtimet "Profesor" dhe "Drejtues kërkimesh", "Profesor i Asociuar" dhe "Mjeshtër kërkimesh", janë, në aspektin zyrtar, plotësisht të barasvlefshme. Personat që mbajnë titullin "Drejtues kërkimesh" ose "Mjeshtër kërkimesh" dhe që kanë qenë ose janë titullarë lëndësh në shkollat e larta, ose autorë a bashkautorë tekstesh universitare, kanë të drejtë të përdorin përkatësisht titullin "Profesor" ose "Profesor i Asociuar".

11. **"Ent Publik"** është një institucion juridik, publik, i pavarur, jobuxhetor, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik, pavarësisht nga pronësia.

12. **"Etikë"**, në kuptimin e përgjithshëm, konsiderohet si tërësi e normave të sjelljes. Etika në veprimtarinë hidroteknike konsiderohet si tërësi e normave të sjelljes dhe parimeve të punonjësve dhe inxhinierëve/specialistëve të shërbimit hidroteknik në veprimet e tyre profesionale.

13. **"Fusha e Veprimtarisë Hidroteknike"** është tërësia e aktiviteteve, me aftësinë profesionale të fituar të inxhinierit hidroteknik, me qëllim shfrytëzimin të pasurive natyrore, fenomeneve dhe dukurive të natyrës për t'i transformuar ato në te mira materiale e dukuri të tjera me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm.

14. **"Hidroteknikë"** disiplinë profesionale në inxhinierinë politeknike në nivelin e arsimit të lartë.

15. **"Inxhinieri"** titull i nivelit të lartë me arsimim universitar i pajisur me diplomë pas dhënies së Provimit të Shtetit.

16. **"Inxhinier Hidroteknik"** është një profesion i rregulluar, që ushtrohet në fushën e veprimtarisë hidroteknike, bazuar në praktika, si: mbështetje të veprimtarisë hidroteknike, ushtrim në praktik të profesionit hidroteknik nëpërmjet studim-kërkimit, projektimit, menaxhimit të projekteve, zbatimit, vlerësimit, ekspertizës teknike, mbikëqyrjes, kolaudimit, si edhe formimit e këshillimit në karrierë dhe punës në institucione dhe organizata.

17. **"Kodi i Etikës dhe Deontologjisë në veprimtarinë Hidroteknike"**, është dokumenti themelor i profesionit të inxhinierit hidroteknik, në të cilin materializohen të gjithë parimet dhe standardet profesionale të detyrueshme për t'u njohur e zbatuar nga çdo anëtar i Urdhrit në praktikën hidroteknike, si edhe nga çdo institucion në sektorin publik dhe privat që ushtron veprimtari hidroteknike.

18. **"Kolaudues"** është vlerësuesi i dokumentacioneve, të cilësisë, të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së veprimeve të arrira dhe çertifikuesi përfundimtarë i regjistrimit të projektit për shfrytëzim apo përdorim.

19. **"Komisioni Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional"**, është organ i gjykimit disiplinor profesional në shërbim të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik dhe funksionon si organ kolegjal vendimmarrës.

20. **"Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional"**, është organ kolegjal vendimmarrës, i shqyrtimit të kërkesave për Ankimi të shërbimit hidroteknik, dhe funksionon si organizëm i gjykimit profesional pranë Urdhrit.

21. **"Komisioni i Provimit të Shtetit"** është organ kolegjal vendimmarrës që funksionon si

institucion i pavarur dhe ka një qëllim të përcaktuar si në këtë ligj.

22. “**Kompetenca**”, përfitimi i aftësive dhe njohurive të duhura për rolin, si dhe veprimin në përputhje me normat, standardet e aplikueshme dhe me kujdesin e duhur.

23. “**Kualifikime Profesionale**”, janë kualifikimet e çertifikuara me një titull studimi, projektimi, një dëshmi aftësie ose një përvojë profesionale.

24. “**Mbikëqyrës**”, kontrolluesi i pajtueshmërisë me rregulloret e zbatimit ndërtimore dhe ligjshmërisë së punëve në përputhje edhe me vlerësimin e kostos dhe kontabilitetin financiar si edhe të legjislacionit teknik dhe juridik, si dhe të standardeve dhe të etikës.

25. “**Menaxher Projekti**”, është zbatues që kryen veprime mbi tërësinë e parimeve, metodave dhe teknikave që përdoren për planifikimin dhe zbatimin me efektivitet të projektit, për një objektiv specifik për t’u përfunduar brenda specifikimeve të caktuara, të datës së fillimit dhe përfundimit, të limiteve të financimit, të konsumimit të burime njerëzore dhe jo njerëzore etj.

26. “**Mision**”, roli/detyra që ka dikush (Institucioni) a diçka në një fushë të caktuar të jetës shoqërore, si dhe shkalla e pjesëmarrjes dhe e ndikimit në një veprimtari shoqërore.

27. “**Monitorues**”, mbikëqyr ose teston periodikisht apo në vazhdimësi, për të përcaktuar nivelin e përputhjes me kërkesat/standardet rregullatore, apo nivelet e ndotësve në mjedise të ndryshme ujore ose në njerëz, bimë dhe kafshë.

28. “**Norma Teknike**”, përfshijnë përcaktimin e tërësisë së funksioneve dhe detyrave të ushtruara të caktuara në inxhinierin hidroteknike, si dhe të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nevojshme për realizimin e tyre, për të siguruar një nivel të lartë zhvillimi.

29. “**Person jo kompetent**”, person i cili nuk ka edukimin profesional të nevojshëm në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës dhe që punon, vlerëson, si edhe kryen ekspertizë teknike pavarësisht nga pozicioni i punës.

30. “**Person juridikë**”, në kuptim të këtij ligji janë të gjithë personat pavarësisht nga forma ligjore që liçencohen/çertifikohen sipas këtij ligji dhe japin shërbime në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës.

31. “**Praktikë profesionale**”, është ushtrimi praktik i një profesioni të rregulluar për një periudhë të caktuar kohe nga ana e kandidatit, në drejtimin e përgjegjësinë e një profesionisti të kualifikuar, që mund të shoqërohet me një formim shtesë, sipas mënyrës së përcaktuar nga urdhri profesional hidroteknik.

32. “**Projektues**”, është veprimi intelektual me një grup aktivitetesh të koordinuara për të zbatuar dhe për të përmbushur objektivat specifike brenda parametrev të përcaktuara, normave, kostos, kohës, për të arritur një produkt unik, që shprehen në dokumente dhe akte që janë vizatimet, skicat, relacionet, llogaritjet, etj. Projektet synojnë arritjen e një qëllimi të përbashkët të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të suksesit.

33. “**Qendra e Trajnimit Profesional Hidroteknik (QTPH)**”, është kolegji profesional i lartë, institucion i edukimi me orientim profesional, që përgatit profesionistë me aftësi praktike, në fushën e veprimtarisë hidroteknike dhe të përshtatshmërisë me të, për studentët me titullin Inxhinier Hidroteknik.

34. “**Reviste Profesionale**”, është revista që publikohen artikuj tekniko-profesional dhe shkencore. Këto lloj artikujsh i drejtohen publikut të gjerë, si dhe atij që studion në një degë të caktuar në universitet dhe veçanërisht në inxhinierin hidroteknike.

35. “**Siguria**”, një sistem procedurash, kontrollësh, revizionimesh dhe veprimesh përmirësuese, për të gjitha studimet kërkimore, monitorimin e mjedisit, marrjen e kampioneve dhe aktivitetet e tjera teknike dhe përdoruese.

36. “**Skemë e veprimtarisë së menaxhimit**”, tërësia e vrojtimeve, e gjykimeve, e veprimeve dhe e akteve që bashkëveprojnë midis objektit dhe subjektit që ndërthuren sipas një skeme dhe marrëdhëniesh të ndryshme me qëllim për të arritur një shërbim apo produkt me efektivitet duke shmangur ndikimet.

37. “**Specialist/nënspecialist plotësues**”, është punonjës që punon në ndërtimin, shërbime, etj, dhe që ka aftësi fizike të të punuarit në fushën e veprimtarisë hidroteknike, me kualifikim dhe edukim të nivelit të ulët.

38. “**Studiues**”, është vroitues, gjykues dhe veprues për të nxjerrë një rezultat ose për të arritur një objektiv të caktuar, duke përdorur, ndërhyrë dhe shfrytëzuar fenomene dhe dukuri të natyrës me qëllim përfitimi në të mirë publik, të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, për të gjithë shoqërinë duke ruajtur mundësinë e sigurimit të burimeve natyrore.

39. “**Shërbime të Inxhinierisë**”, tërësia e veprimeve për të arritur një objektiv në fushën e veprimtarisë së inxhinierisë në këtë rast hidroteknik.

40. “**Urdhëri i Inxhinierit Hidroteknik**”, është ent publik jobuxhetor i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit në fushën e veprimtarisë hidroteknike dhe rregullon veprimtarinë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

41. “**Urdhër Profesional Hidroteknik**”, është titull pune që i jepet anëtarit të Urdhrit pas trajnimit tekniko-profesional, i cili ka prezantuar punime kërkim-studimi dhe zbatimi, të cilat janë vlerësuar nga panele/borde inxhiniero-teknik të Urdhrit.

42. “**Vlerësues**” dhe “**Ekspert Teknike**”, vlerësues/oponent, i cili identifikon, reflekton dhe gjykon për vlerën dhe efektet të asaj që është bërë. Vlerësimi i një projekti në vazhdim ose të përfunduar, sipas stadeve të programimit, projektimit, zbatimit dhe rezultateve. Me qëllim përcaktimin e rëndësisë, përmbushjen e objektivave të zhvillimit, të efikasitetit, efektivitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë.

Vlerësimet pas ekzekutimit të çdo faze konsiderohen ekspertize teknike.

43. “**Zhvillim i Qëndrueshëm**”, procesi aplikimit/përdorimit të burimeve humane dhe natyrore për të zhvilluar sigurinë, mirëqenien dhe cilësinë e jetës për të gjithë shoqërinë duke ruajtur mundësinë e sigurimit të burimeve natyrore.

## Neni 5

### Fushat e veprimtarisë hidroteknike

Ky ligj e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë Inxhinierët Hidroteknik që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë, si në sistemin

publik dhe atë privat.

Fushat e veprimtarisë hidroteknike, objektë e këtij ligji janë:

1. Përdorimi në mënyrë racionale dhe të qëndrueshme i të mirave materiale të ardhura nga vetë natyra.

2. Shfrytëzimi i pasurive natyrore, fenomeneve dhe dukuri të natyrës për t'i transformuar ato në të mira materiale e dukuri të tjera me qëllim përfitimi.

3. Veprimtari shërbimi hidroteknik me interes publik, të cilat lidhen me sigurinë dhe emergjencat, shëndetin dhe zhvillimin ekonomik, në fushat e veprimtarisë së hidroteknikës të grupuara nga Urdhri, si më poshtë:

a) "*Burimet Ujore*", ku hidrologjia trajton të gjithë fazat e ujit në tokë, si edhe menaxhimin dhe krijimin e burimeve të reja ujore duke maksimizuar shfrytëzimin optimal, ku Inxhinieria Hidroteknike në këtë fushë përfshin:

- i. Studimin e rrjedhjes ujore sipërfaqësore;
- ii. Studimin e rrjedhjes nëntokësore;
- iii. Kryerjen e matjeve dhe certifikimin e të dhënave.

b) "*Furnizimi me Ujë të pijshëm, Ujërat e Zeza dhe Drenazhimi Urban*", ku fusha e veprimit të Inxhinierisë Hidroteknike përfshin:

- i. Furnizimi me ujë dhe rrjedhjet në rrjet;
- ii. Cilësia e ujit të pijshëm, pasurimi dhe dezinfektimi i tij;
- iii. Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe drenazhimit urban;
- iv. Impiantet e pastrimit urban dhe industrial.

c) "*Përmbytjet dhe Menaxhimi i Rreziqeve*", ku Inxhinieria hidroteknike në këtë fushë përfshin:

- i. Menaxhimi i riskut ndaj përmbytjeve, si edhe erozionit lumor dhe bregdetar;
- ii. Siguria e digave, dambave, argjinaturave, porteve, hidroporteve, etj.
- iii. Menaxhimi dhe monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe të drenazhimit, para dhe pas përdorimit.

ç) "*Energjia dhe Ndryshimet Klimatike*", fushë në të cilën Inxhinieria hidroteknike përfshin:

- i. Mbi ndryshimet klimatike;
- ii. Prodhimin e elektricitetit nga burime të rinovueshme;
- iii. Eficiencën e energjisë;
- iv. Gjenerimin e energjisë nga burime alternative.

d) "*Përmirësime Ujore*", që janë ujitja dhe kullimi i tokave në mënyrë eficiente. Inxhinieria hidroteknike në këtë fushë përfshin:

- i. Administrimin e vëllimeve dhe transportin e ujit për ujitje;
- ii. Menaxhimin dhe shpërndarjen në kohë të ujit në zonat të cilat do të ujitën;
- iii. Infrastrukturën e kullimit dhe drenazhimit;

dh). "*Projekt Konstruktiv*". Projekti Konstruktiv planifikohet për ndërtim me vetitë e tij teknike, të ndërtimit, të qëllimit dhe vendosjes në tokë, duke përfshirë mënyrën e ekzekutimit të punëve ndërtimore. Inxhinieria hidroteknike në këtë fushë përfshin:



- i. Llogaritjen hidraulike dhe konstruktivimi i veprave hidroteknike dhe të ndërtimit të infrastrukturës tokësore dhe nëntokësore të transportimit të ujit;
  - ii. Llogaritjen dhe konstruktivimi, si dhe të sistemeve të infrastrukturës së transportit;
  - iii. Llogaritjen e konstruksioneve betonarme të ndërtimeve industriale dhe civile me lartësi;
  - iv. Llogaritjen e konstruksioneve metalike të ndërtimeve industriale dhe civile me lartësi;
  - v. Llogaritjen e sistemeve të furnizimit me ujë, shkarkimin e ujërave dhe sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit.
- e). *“Bordi i Rregullave dhe i Menaxhimit”*. Inxhinieria hidroteknike në këtë fushë lidhet me legjisllacionin, strukturën institucionale dhe qeverisjen, regjimet rregullatore dhe vlerësimin mjedisor dhe me menaxhimin e projekteve të fushës së veprimit në aspektin e:
- i. Menaxhimit të projekteve dhe të tregut për zhvillim të qëndrueshëm;
  - ii. Kontrollit të përputhshmërisë, rregullshmërisë teknike dhe ligjshmërisë për zhvillim të qëndrueshëm të projekteve.

#### Neni 6

#### **Parimet e veprimitarisë së Inxhinierit Hidroteknik**

1. Inxhinierët hidroteknike do të përkrahin dhe çojnë përpara integritetin profesional dhe etik nëpërmjet:
  - a) Përdorimit të njohurive dhe aftësive për përparimin e mirëqenies njerëzore dhe mjedisit;
  - b) Sjelljes në mënyrë të ndershme dhe të paanshme dhe shërbimit me devotshmëri për publikun, të punësuarve dhe të klientëve;
  - c) Përpjekjes për rritjen e kompetencës dhe prestigjit të profesionit;
  - d) Përkrahjes së shoqërive profesionale të përfshira në disiplinën e tyre.
2. Inxhinierët hidroteknike do të mbajnë si parim parësor sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e publikut dhe do të përpiqen të pajtohen me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
3. Inxhinierët hidroteknike do të bëjnë shërbime vetëm në fushën e kompetencave dhe aftësive të përfituara dhe çertifikuara/liçencuara të tyre.
4. Inxhinierët hidroteknike do të lëshojnë deklarata në mënyrë objektive dhe të sinqertë.
5. Inxhinierët hidroteknike do të sillen në mënyrë profesionale me çdo punëdhënësi apo klient, si agjentë të besuar ose kujdestarë, dhe do të anashkalojnë konfliktet e interesit.
6. Inxhinierët hidroteknike do të ndërtojnë reputacionin profesional me meritën e shërbimeve të tyre dhe nuk do të konkurrojnë në mënyrë të pandershme me të tjerët.
7. Me synim, normimin e rregullave mbi etiken dhe sjelljen e inxhinierëve, për të siguruar dhe garantuar profesionalizëm, pavarësi, ndershmëri, integritet dhe korrektësi në ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre profesionale në interes të publikut e shoqërisë, për të parandaluar dhe ndëshkuar çdo veprim e sjellje korruptive të tyre, inxhinierët do të sillen në mënyrë të tillë që të përkrahin dhe përmirësojnë integritetin dhe dinjitetin e profesionit dhe do të veprojnë në përputhje me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të inxhinierit hidroteknike kundër praktikave të ryshfetit, korrupsionit dhe mashtrimit.
8. Inxhinierët hidroteknike do të vazhdojnë zhvillimin profesional në karrierën e tyre dhe do

të sigurojnë mundësi për zhvillimin profesional për Ato/Ata inxhinierë që kanë nën mbikëqyrje, duke nxitur edhe barazinë gjinore në ushtrimin e profesionit në veprimtarinë hidroteknike.

9. Inxhinierët hidroteknike nuk duhet të nxisin, urrejtje kundrejt inxhinierëve të tjerë dhe institucionit përfaqësues.

Neni 7

### **Statusi**

1. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik (UIH) është ent publik jobuxhetor i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit në fushën e veprimtarisë hidroteknike dhe rregullon veprimtarinë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

2. Urdhri Profesional i Inxhinierit Hidroteknik është person juridik i pavarur dhe përfaqëson Inxhinierët Hidroteknike, mbron dhe zhvillon disiplinën e Hidroteknikes, si edhe ka të drejta ekskluzive për hartimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm në fushën e veprimtarisë së tij.

3. Urdhri Profesional i Inxhinierit Hidroteknik ka kompetencë lëndore dhe territoriale, brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë.

## **KREU II**

### **TË DREJTAT E URDRIT**

Neni 8

#### **Të drejtat e Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik**

Në bazë dhe zbatim të këtij ligji Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik ushtron këto të drejta:

1. E drejta e vetëqeverisjes:

- a) nxjerr vendime, urdhra dhe udhëzime që janë të detyrueshme për veprimtarinë e inxhinierëve hidroteknik;
- b) miraton buletine, manuale, metoda dhe rregullore teknike të detyrueshme për zbatim në projekte zhvillimi dhe administrimi në fushën e veprimtarisë hidroteknike;
- c) krijon struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- ç) krijon komisione të përhershme dhe të përkohshme sipas nevojave për veprimtarinë hidroteknike.

2. E drejta e edukimit të nivelit të lartë:

- a) zhvillon edukim të vazhdueshëm profesional gjatë karrierës dhe siguronë mundësi për zhvillim profesional për ata inxhinierë/specialist dhe nënspecialist që ka nën mbikëqyrje;
- b) vlerëson performancën e inxhinierëve dhe specialistëve që ka nën mbikëqyrje.

3. E drejta e certifikimit/liçencimit profesional:

- a) ushtron të drejtën e certifikimit/liçencimit të profesionisteve të nivelit të lartë të inxhinierëve hidroteknikë;

b) ushtron të drejtën e vlerësimit, kategorizimit dhe pajisjes me dëshmi profesionale të specialisteve të nivelit jo inxhinier që punojnë në fushat e veprimtarisë së hidroteknikës;

4. E drejta e çertifikimit të shërbimeve:

a) ushtron të drejtën e çertifikimit të të dhënave dhe matjeve brenda fushës së veprimtarisë hidroteknike;

b) ushtron të drejtën e matjeve, analizave dhe vlerësimit, si dhe ekspertizës teknike.

5) Të promovojë, botojë dhe shpërndajë standardet e reja ndërkombëtare, si dhe të garantojë respektimin e tyre në disiplinën hidroteknike/veprimtarinë hidroteknike, si dhe për mbështetjen e programeve të edukimit profesional gjatë karrierës.

6. E drejta e pronësisë:

a) ushtron të drejtën e pronësisë që e fiton, shet dhe jep në përdorim pronën e paluajshme ose të luajshme të tij, si dhe ushtron të drejta të tjera sipas legjislacionit në fuqi për çështjet e pronësisë;

b) e drejta e pronësisë ushtrohet nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.

7. E drejta e kryerjes së veprimtarive ekonomike:

a) ushtron të drejtën e veprimtarisë ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit, nëpërmjet krijimit të njësive ekonomike e institucione në varësi të tij;

b) ushtron të drejtën e përdorimit të të ardhurave që përfitohen nga veprimtaria ekonomike për mbështetjen dhe përmbushjen e funksioneve të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik.

8. E drejta e personit juridik, gëzon dhe ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi:

a) të drejtën e lidhjes së kontratës;

b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;

c) të drejtën e ngritjes së padisë civile dhe penale;

ç) të drejtën e mbajtjes së llogarive;

d) të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

### KREU III

## BASHKËPUNIMI, BOTIMET/PUBLIKIMET DHE KOMUNIKIMI ELEKTRONIK

### Neni 9

#### **Bashkëpunimi**

1. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse që administron ekonominë në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës dhe institucionet e saj vartëse, si edhe me ministritë, institucionet qendrore dhe vendore, akademinë e shkencave, institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor,

organizma të tjerë, publikë ose jopublikë, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi.

2. Çdo bashkëpunim ndërmjet Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, kryhet në rrugë institucionale në zbatim të plotë të legjislacionit në Republikën e Shqipërisë, si dhe mbështetur në parimin e partneritetit dhe reciprocitetit.

3. Urdhri, informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për fushën e hidroteknikës lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

4. Institucionet në fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bashkëpunojnë me "Urdhrin" gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

5. Ministrinë e përmendura në pikën 1 të këtij neni bashkëpunojnë me Urdhrin për hartimin e projekt-akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumenteve të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës.

## Neni 10

### **Publikime, botime dhe e drejta e publikut për informim**

1. Vendimet dhe aktet e nxjera nga Urdhri që u drejtohen të tretëve, regjistrohen në regjistër dhe publikohen/botohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Urdhrit, në format elektronik sipas akteve të brendshme rregullatore dhe legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit."

2. Urdhrit kryen publikimin në Buletin brenda pesë ditëve nga data e miratimit.

3. Publikimi në Buletinin e Njoftimeve përbën publikim zyrtar, sipas dispozitave të këtij ligji, si dhe vlerësohet e njohur dhe u drejtohet të tretëve nga dita e publikimit.

4. Aktet e publikuara vlerësohen gjithnjë të njohura dhe përbëjnë akt zyrtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Aktet si, vendimet, urdhërat dhe udhëzimet që kanë karakter administrativ të brendshëm nuk botohen.

6. Vendimet dhe aktet e nxjera nga Urdhri që u drejtohen të tretëve, do të jenë në dispozicion të personave juridikë dhe fizikë kërkues, në përputhje dhe brenda kufijve të parashikuar nga kuadri rregullator dhe legjislacioni përkatës në fuqi që përcakton disponibilitetin e informacionit me rëndësi publike.

7. Çdo person ka të drejtë të njihet me vendimet dhe aktet e nxjera nga Urdhri, nëpërmjet dokumentit origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

8. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;

- d) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- e) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

9. E drejta për vënien në dispozicion të vendimeve dhe akteve të nxjera nga Urdhri kufizohet vetëm sipas rasteve të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit.

10. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara për vënien në dispozicion të vendimeve dhe akteve të nxjera nga Urdhri, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

## Neni 11

### **Komunikimi elektronik**

Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik, për të garantuar lehtësimin e procedurave dhe ofrimin e shërbimeve, në favor të subjekteve të interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bashkëpunon me autoritete të tjera publike dhe mundëson ndërlidhjen dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave, të regjistruara në bazën e saj elektronike, me regjistra apo baza të dhënash elektronike të autoriteteve të tjera publike, si brenda, ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

## KREU IV

### ANËTARI I URDHRI

## Neni 12

### **Kriteret e anëtarësisë në Urdhër**

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e Inxhinierit Hidroteknik, si edhe të punojë në fushën e veprimtarisë hidroteknike në institucionet/sectorin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit, si edhe pa qenë i pajisur me licencën/çerifikatë për atë shërbim të lëshuar nga ky organizëm.

2. Janë anëtarë të Urdhrit të Inxhinierëve Hidroteknik të gjithë Inxhinierët që ushtrojnë profesionin e Inxhinierit Hidroteknik në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë;
- b) të kenë diplomën me titullin e Inxhinierit Hidroteknik të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë brenda apo jashtë shtetit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- c) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, në momentin e kërkesës për anëtarësim;

ç) të njohin dhe të deklarohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e këtij ligji, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë, si edhe legjislacionin në fuqi që rregullon ushtrimin e profesionit të Inxhinierit Hidroteknik.

3. Çdo Inxhinieri Hidroteknik, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri, apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë, duhet të anëtarësohet paraprakisht në Urdhrit Inxhinierit Hidroteknik të Republikës së Shqipërisë, si edhe duhet të ketë këto dokumente:

- a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;
- b) çertifikatën e mirësjelljes (*Good Standing Certificate*) nga Urdhri/dhoma apo shoqata e Inxhinierëve Hidroteknik të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;
- c) njësimin (konvalidimin) e diplomës dhe çertifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj;
- ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik;
- d) dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, të vërtetuar nga një autoritet i licencuar nga shteti.

Inxhinieri Hidroteknik jorezident detyrimisht punon me përkthyes.

4. Anëtarët e Urdhrit kanë detyrim të paguajnë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të licencimit/çertifikimit dhe për shërbime të tjera administrative, sipas përcaktimit në këtë ligj dhe statutin e urdhrit.

5. Individëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilët e kanë të dokumentuar formimin dhe kualifikimin profesional për ushtrimin e këtij profesioni, sipas shkronjës "b", të pikës 2, të këtij neni, u lind e drejta e menjëhershme e anëtarësitimit në Urdhër.

### Neni 13

#### **Të drejtat e anëtarit të Urdhrit**

Anëtari i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik ka të drejtë:

1. Të ushtrojë profesionin në profilin e licencuar/çertifikuar.
2. Anëtarët e Urdhrit kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të Urdhrit në organet e Urdhrit kur i shkelen të drejtat dhe mundësitë për ushtrim autonom, të lirë dhe të pavarur të profesionit. Anëtarët pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ pranë Urdhrit në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.
3. Të marrë pjesë në shqyrtimin nga organizmat e Urdhrit për probleme që kanë të bëjnë me personin e tij.
4. Të kërkojë krijimin e kushteve të favorshme për edukimin e vazhdueshëm profesional në karrierë.
5. Të marrë pjesë në aktivitete profesionale sipas gурpit që përfaqëson shërbimin e tij.

6. Anëtarët e Urdhrit kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të Urdhrit në organet e Urdhrit kur i ndërpritet anëtarësia dhe i hiqet licenca/çerifikata individuale e ushtrimit të profesionit me vendim disiplinor të formës së prerë nga organet e Urdhrit sipas dispozitave të këtij neni. Anëtarët pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ pranë Urdhrit në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

#### Neni 14

##### **Ndërprerja e anëtarësimit**

1. Anëtarit të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik i ndërpritet anëtarësia në këto raste:
  - a) kur vdes;
  - b) kur i hiqet licenca/çerifikata individuale e ushtrimit të profesionit me vendim disiplinor të formës së prerë nga organet e Urdhrit apo të Gjykatës;
  - c) kur është duke vuajtur dënimin penal me heqje lirie;
  - ç) kur nuk paguan kuotizacionet në përputhje me afatet e vendosura në këtë ligj dhe statut.
2. Vendimi për ndërprerje dhe pezullim të anëtarësisë i komunikohet zyrtarisht personit.

#### Neni 15

##### **Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit**

Anëtari i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik ka këto detyrime:

- a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale, në përshtatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit shqiptar në fushën e hidroteknikës, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe statutin e Urdhrit;
- b) të punojë për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësisë në veprimtarinë hidroteknike, si edhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit të vazhdueshëm profesional;
- c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative, në përputhje me këtë ligj, statutin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

#### KREU V

##### **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI**

#### Neni 16

##### **Organet kryesore**

Urdhri Profesional i Inxhinierit Hidroteknik, si organ publik, drejtohet nga organe përfaqësuese, të cilat do të ushtrojnë veprimtarinë vendimmarrëse dhe ekzekutive në mënyrë kolegjiale.

1. Organet kryesore të Urdhrit janë:

- a) Asambleja Kombëtare;
- b) Këshilli Kombëtar;
- c) Kryesia e Urdhrit;
- ç) Presidenti i Urdhrit;
- d) Komisioni Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional;
- dh) Zëvendës Presidenti i Urdhrit;
- e) Sekretari Përgjithshëm i Urdhrit.

2. Urdhri përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë tij, si:

- a) Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional;
- b) Qendra e Trajnimit Profesional Hidroteknik (QTPH);
- c) Komisione të tjera rast pas rasti;
- ç) Administrata ndihmëse;
- d) Rregjistri Kombëtar i Urdhrit;
- dh) Baza e të dhënave dhe rregjistri elektronike;
- e) Biblioteka dhe enti botues.

Neni 17

### **Asambleja Kombëtare**

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë përfaqësues/drejtuës i Urdhrit dhe përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.

2. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga:

- a) Presidenti i Urdhrit;
- b) Kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të asamblesë.

3. Asambleja Kombëtare ka këto funksione:

- a) zgjedh Këshillin Kombëtar me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;
- b) zgjedh Presidentin e Urdhrit me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj për një mandat 7-vjeçar;
- c) miraton Statutin e Urdhrit;
- ç) miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierit Hidroteknik;
- d) miraton rregulloren për Gjykimin Disiplinor Profesional;
- dh) miraton rregulloren për regjistrimin e anëtarësimit;
- e) analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;
- ë) shqyrton raportin e auditit të jashtëm, sipas përcaktimit në statut.

4. Miraton kuotizacionin e anëtarësisë dhe tarifën e shërbimit, si edhe vlerësimin e krediteve;

5. Përbërja e anëtarëve të asamblesë dhe procedurat e zgjedhjes së tyre përcaktohen në Statutin e



Urdhrit.

6. Zgjedhjet në organet e sipërpërmendura duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për gjinin më pak të përfaqësuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për barazinë gjinore në shoqëri.

Neni 18

### **Këshilli Kombëtar**

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit është organi vendimmarrës ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 31 anëtarë, ndër të cilët 20 janë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare dhe 11 të tjerët janë, përkatësisht:

- a) Presidenti i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik;
- b) Zëvendës Presidenti i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik;
- c) një përfaqësues nga Këshilli Ministrave;
- ç) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për veprimtarinë hidroteknike;
- d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për edukimin;
- dh) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punësimin;
- e) një përfaqësues nga shoqata e Kryetarëve të Bashkive;
- ë) një përfaqësues nga Akademia e Shkencave së Republikës së Shqipërisë;
- f) një përfaqësues nga institutet e kërkim-studimit në fushën hidroteknike;
- g) një përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë të shkencave hidroteknike;
- h) një përfaqësues nga Shoqatat e Hidroteknikëve, të caktuar nga Presidenti i Urdhrit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në statut.

2. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

- a) miraton strukturën e vet organizative;
- b) merë vendime në zbatim të këtij ligji;
- c) zgjedh Zëvendës Presidentin e Urdhrit me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj për një mandat 7-vjeçar;
- ç) zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm e Urdhrit; me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj për një mandat 7-vjeçar;
- d) zgjedh Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Etikës dhe Gjyqimit Disiplinor Profesional, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj për një mandat 3-vjeçar;
- dh) zgjedh Drejtorin e Qendrës të Trajnimit Profesional Hidroteknik (QTPH);
- e) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
- ë) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit;
- f) shqyrton dhe miraton projektbuxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;
- g) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim, Asamblesë Kombëtare;
- gj) miraton rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit;

- h) miraton rregulloren për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme;
  - i) miraton rregullat për organizimin dhe funksionimin e (QTPH-së);
  - j) miraton rregullat për dhënien e të drejtës së ushtrimit të profesionit të inxhinierit hidroteknike;
  - k) miraton rregulloren e praktikës profesionale;
  - l) miraton nivelet e kualifikimit të inxhinierit hidroteknik gjatë ushtrimit të profesionit dhe zhvillimit të karrierës profesionale
  - ll) miraton nivelet e kualifikimit, kategorizimet, emërtimet dhe pozicionin në shërbimin hidroteknik të
    - specialistëve dhe nën specialistëve;
  - m) miraton programet e trajnimit profesional hidroteknik;
  - n) miraton Komisionin e Ankimit të Shërbimit Profesional mbi bazën e propozimit nga Kryesia e Urdhrit;
  - nj) miraton rregulloren e gjyqimit profesional të Urdhrit;
  - o) miraton buletine, manuale, metoda, udhëzime dhe rregullore, për kryerjen e aktiviteteve në fushën e veprimtarisë hidroteknike;
  - p) analizon veprimtarinë e Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, nëse ajo është në përputhje me këtë ligj, statutin dhe rregulloret e Urdhrit;
  - q) ngre grupe pune *ad-hoc* për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesionit të Inxhinierit Hidroteknik;
  - r) mban dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të Urdhrit;
  - s) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe financiar të Urdhrit.
3. Presidenti, Zëvendës Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit janë njëkohësisht edhe Drejtuesit e Asamblesë dhe Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik.
4. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 7 vjet, në bazë të rregullave të përcaktuara në statutin e Urdhrit.
5. Mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij, të shpallur nga komisioni i zgjedhjeve. Nëse nuk mbledhen më shumë se gjysma e anëtarëve, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret dhjetë ditë më vonë, por jo më shumë se tri herë. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrjeje nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, Këshilli Kombëtar konsiderohet i shpërndarë.
6. Vendimet e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, do të quhen të vlefshme kur për miratimin e tyre marrin pjesë jo më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij dhe për miratimin e tyre nevojiten 50 për qind plus 1 votë të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.
7. Anëtari i Këshillit Kombëtar nëse nuk merr pjesë në mbledhje tri herë rreshtë, atëherë mandati i tij është automatikisht i zëvendësuar.

Neni 19

### **Kriteret për anëtarësim në Këshillin Kombëtar**

1. Anëtari i Këshillit Kombëtar duhet të plotësojë këto kritere:
  - a) të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
  - b) të jetë anëtar i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik;
  - c) të ketë përvojë jo më pak se 5 vjet në ushtrimin e profesionit të Inxhinierit Hidroteknik;
  - ç) të mos ketë marrë masë disiplinore në 3 vitet e fundit dhe të mos ketë asnjë precedent penal në ushtrimin e profesionit;
  - d) preferencë kanë kandidatët me grada shkencore dhe tituj akademik "Profesor dhe Profesor i Asocuar"/"Drejtues kërkimesh dhe Mjeshtër kërkimesh" me "Post Doktoraturë", "Doktoraturë" dhe "Urdhri Hidroteknik".
2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar kanë të drejtën e vetëm një rizgjedhjeje.

## Neni 20

### Kryesia e Urdhrit

1. Kryesia është organ ekzekutiv i Urdhrit.
2. Kryesia përbëhet nga:
  - a) Presidenti i Urdhrit;
  - b) Zëvendës Presidenti i Urdhrit,
  - c) Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit;
  - ç) Kryetari i Komisionit të Etikës dhe Gjyimit Disiplinor Profesional;
  - d) Drejtori i Qendrës të Trajnimit Profesional Hidroteknik.
3. Kryesia e Urdhrit organizon dhe drejton Urdhritin në bazë e në zbatim të këtij ligji, statutit të tij dhe vendimeve të Asamblesë dhe Këshillit Kombëtar.
4. Kryesia e Urdhrit zbaton të drejtat e ngarkuara në këtë ligj, akteve nënligjore, si edhe ligjeve të tjera të Republikës së Shqipërisë.
5. Kryesia e Urdhrit është përgjegjës:
  - a) për organizimin dhe drejtimin e punës së administratës së Urdhrit;
  - b) për ndjekjen e vazhdueshme të zbatimit të vendimeve të Asamblesë dhe Këshillit Kombëtar;
  - c) për harmonizimin, bashkërendimin e punës, monitorimin dhe ofrimin e asistencës teknike;
  - ç) për hartimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e administratës mbështetëse të Kryesisë së Urdhrit, të cilat caktohen në statut dhe rregullore,
  - d) për hartimin e buletineve, manualeve, metodave, udhëzimeve dhe rregulloreve, për kryerjen e aktivitetit në fushën e veprimtarisë hidroteknike.
6. Kryesia e Urdhrit ushtron edhe këto kompetenca:
  - a) thërret Këshillin Kombëtar të Urdhrit;
  - b) përgatit rregulloren për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme;
  - c) përgatit Statutin dhe rregulloret e Urdhrit;
  - ç) përgatit Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierisë Hidroteknike;

- d) përgatit projektvendimin për miratim e Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional;
- dh) përgatit rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit;
- e) përgatit rregulloren e praktikës profesionale;
- ë) përgatit rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit;
- f) përgatit projektvendimin për përcaktimin e tarifave të shërbimit, si edhe vlerësimin e krediteve;
- g) përgatit projekt programin dhe projekt buxhetin e Urdhrit;
- gj) përgatit raportin vjetor të Urdhrit;
- h) përgatit programet e trajnimit profesional hidroteknik;
- i) përgatit mbledhjet e Asamblesë.

7. Kryesia e Urdhrit nëpërmjet Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional, kryen kontroll të personave juridik të certifikuar/liçencuar sipas këtij ligji mbi zbatueshmërin e legjislacionit në fuqi.

8. Kryesia e Urdhrit i propozon Këshillit Kombëtar kandidatura alternative për zgjedhjen e Drejtorit të Qendrës së Trajnimit Profesional Hidroteknik.

9. Për kryerjen e detyrave të saj, Kryesia e Urdhrit nxjerr vendime të brendshme. Vendimet e brendshme merren me shumicë të thjeshtë. Në rast barazimi votash, vota e Presidentit të Urdhrit është përcaktuese.

10. Kryesia e Urdhrit ka të drejtën e kryerjes së shërbimit të ndërmjetësimit për çështjet brenda fushës së veprimtarisë hidroteknike.

11. Detyrat e Zëvendës Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm, Kryetarit të Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional dhe drejtuesit të Qendrës të Trajnimit Profesional Hidroteknik përcaktohen në statutin e Urdhrit.

## Neni 21

### **Papajtueshmëria me Funkcionin e Anëtarit**

1. Për anëtar në Këshillin Kombëtar të Urdhrit, ka të drejtë të kandidojë çdo inxhinier hidroteknik që përmbush kriteret dhe detyrimet e këtij ligji, si dhe të rregullores për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme.

2. Papajtueshmëria me funksionin e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Urdhrit është i çdo inxhinieri hidroteknik që:

- a) është i punësuar në administratën e Urdhrit,
- b) është i punësuar në agjencitë shtetërore apo shoqëritë tregtare e formës person juridik, me kapital shtetëror që kanë objekt dhe ushtrojnë profesionin në fushat e veprimtarisë së Hidroteknikës;
- c) është i punësuar në institucionet publike qendror dhe vendor;
- ç) është kryetar i një partie politike deri në nivelin e dytë;
- d) është deputet;
- e) është drejtues i një enti publik.

## Neni 22

### Presidenti i Urdhrit

1. Presidenti i Urdhrit zgjidhet me votim të fshehtë nga Asambleja midis jo më pak se 2 kandidaturave alternative me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj, për një mandat 7-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë.
2. Kandidaturat për President të Urdhrit të Inxhinierëve Hidroteknik duhet të përmbushin këto kritere:
  - a) të jetë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
  - b) të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë në profesion;
  - c) të ketë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;
  - ç) të mos jetë marrë ndaj tij masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;
  - d) të ketë prestigj dhe reputacion etiko-moral dhe profesional;
  - dh) të ketë kryer studime dhe/ose botime shkencore;
  - e) të mos jetë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje në ushtrimin e profesionit.
  - ë) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
  - f) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
3. Funkzioni i Presidentit të Urdhrit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.
4. Detyrat e Presidentit të Urdhrit janë:
  - a) drejton dhe organizon punën e veprimtarinë e Urdhrit;
  - b) përfaqëson Urdhrin në marrëdhënie me të tretët dhe nënshkruan në emër të tij;
  - c) raporton në Asamblen Kombëtare për aktivitetin e përgjithshëm;
  - ç) raporton në Këshillin Kombëtar për aktivitetin semestral;
  - d) nënshkruan vendimet e Kryesisë, Këshillit të Kombëtar dhe të Asamblesë Kombëtare;
  - dh) zbaton detyrat e përcaktuara në statut.
5. Presidentit të Urdhrit i përfundonë mandati përpara kohe në këto raste:
  - a) kur merret vendim nga Asambleja Kombëtare, me votat e jo më pak se dy të tretave të anëtarëve të saj;
  - b) kur jep dorëheqjen;
  - c) kur dënohet me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - ç) kur humbet zotësinë e plotë për të vepruar;
  - d) kur bëhet i paaftë, për arsye shëndetësore, për të kryer detyrat e tij, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor.
6. Në zbatimin e detyrave dhe kompetencave të tij, Presidenti i Urdhrit nxjerr urdhra të brendshëm.
7. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e Presidentit të Urdhrit të Inxhinierëve Hidroteknik përcaktohen në Statutin e Urdhrit.

## KREU VI

### BUXHETI

#### Neni 23

#### **Financimi**

1. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik është ent publik jobuxhetor, ai ka buxhetin e tij, të cilin e miraton dhe e administron Këshilli Kombëtar në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga ky Këshill.
2. Burimet financiare të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik janë të ardhurat nga:
  - a) kuotizacionet e anëtarësisë, masa e të cilave përcaktohet me vendim të Urdhrit;
  - b) tarifat e regjistrimit;
  - c) tarifat e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri;
  - ç) tarifat e shërbimit;
  - d) grante, donacione të ndryshme vendase dhe të huaja të ligjshme;
  - dh) aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
3. Të ardhurat e siguruara, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i përdor për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij në përputhje me këtë ligj.

## KREU VII

### E DREJTA, PRAKTIKA PROFESIONALE, PROVIMI I SHTETIT

#### Neni 24

#### **E drejta e ushtrimit të profesionit**

1. Profesionit i Inxhinierit Hidroteknik ushtrohet, me cilësinë e të vetëpunësuarit ose të të punësuarit, në sektorët publik të institucioneve qendrore dhe vendore, në sektorin akademik apo mësimdhënie, sipas kërkesave dhe parimeve të përcaktuara nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik.
2. Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të Inxhinierit Hidroteknik e ka çdo person, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj si më posht:
  - a) të ketë kryer ciklin tre plus dy të studimeve në nivel master profesional, apo ciklin e plotë në kursin e Inxhinierisë Hidroteknike;
  - b) të kryejë praktikën profesionale;
  - c) të ketë dhënë provimin e shtetit;
  - ç) të ketë dokument zyrtar diplomën me titullin inxhinier hidroteknik;
  - d) të regjistrohet në Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik
3. Nuk mund të ushtroshë profesionin në veprimtarinë hidroteknike pa u regjistruar më parë

në Urdhër, si edhe pa u pajisur me dokumentin e identifikimit (ID).

4. Ushtrimi i veprimtarisë hidroteknike në sektorin publik, privat, institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, lejohet vetëm për Inxhinierët Hidrotenik të cilët plotësojnë kushtet e këtij ligji.

5. Juridiksioni i anëtarëve të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, individual dhe të personave juridikë, ushtrojnë shërbimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Çdo shtetas i huaj, për të ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë, u nënshtrohet kërkesave të legjislacionit në fuqi lidhur me qëndrimin dhe punësimin e të huajve, si edhe dispozitave që parashikohen në këtë ligj.

## Neni 25

### Praktika profesionale

1. Përpara kryerjes së provimit të shtetit kandidati për titullin Inxhinier Hidroteknik duhet të kryejë praktikën profesionale.

2. Praktikë profesionale është ushtrimi i profesionit për një periudhë jo më pakë se 1 vit nga ana e kandidatit, sipas *sistemit dual* nën drejtimin e përgjegjësive të një profesionisti hidroteknik të kualifikuar. Kandidati gjatë kohës së praktikës do të mund të pajiset me një formim shtesë, sipas mënyrës së përcaktuar në statusin e Urdhrit dhe legjislacionit në fuqi.

3. Në rast së kandidati nuk zbaton programin e praktikës profesionale në kohën dhe detyrimet e përcaktuara në statutin e Urdhrit, periudha kohore e praktikës me kërkesë të tij përsëritet edhe për një vit tjetër, në rast të kalimit të afatit të përcaktuar më sipër, atëherë kandidati nuk kualifikohet, në këtë rast Kryesia e Urdhrit i propozon Këshillit Kombëtar, për marje vendimi të arsyetuar.

4. Praktika kryhet nën drejtimin e një profesionisti hidroteknik, i cili e ushtron profesionin prej jo më pak se tre vjetësh, të ketë plotësuar kushtin e kategorisë “Lektor”, si edhe të jap opinion të mjaftueshme me shkrim për përgatitjen teorike dhe praktike të praktikantit.

5. Si rregull udhëheqësi i praktikës nuk duhet të ketë më shumë se një kandidat në programin e praktikës profesionale.

6. Në përfundim të praktikës profesionale, kandidati i nënshtrohet “Vlerësimit për aftësimin praktik”. Praktika profesionale konsiderohet e kryer vetëm pas vlerësimit pozitiv të aftësimit.

7. Çdo praktikan, do të quhet ndryshe kandidat për titullin inxhinier hidroteknik, deri në marjen e titullit, si edhe çdo person që nuk do të arrijë të marrë titullin do të jetë nën këtë emertim. Çdo student që nga momenti i fillimit të studimeve mund të regjistrohet në urdhër, si dhe mund të ndjek çdo aktivitet pa kufizime.

8. Modalitetet e organizimit të vlerësimit të aftësimin praktik përcaktohen në rregulloren e praktikës profesionale, që miratohet me vendim të Këshillit të Kombëtar të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik.

## Neni 26

### **Titulli Inxhinier Hidroteknik**

1. Provimi i Shtetit:
  - a) realizon garancitë dhe sigurimin publik për përgjegjësitë, që sjell ushtrimi i profesioni të Inxhinierit Hidroteknik;
  - b) kryen testimin e njohurive të kandidatit, që aspiron ushtrimin e profesionit të Inxhinierit Hidroteknik, duke siguruar uniformitet në vlerësimin e kandidatëve, në nivel shtetëror, përmes verifikimit të aftësive të nevojshme profesionale.
2. Përmbajtja/bankë testi e/i Provimit të Shtetit hartohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së hidroteknikës.
3. Kandidati gjatë marrjes së titullit bënë betimin, deklarata e betimit formulohet nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik.
4. Pas përfundimit me sukses të Provimit të Shtetit, kandidatit i jepet titulli “Inxhinier Hidroteknik”.

## Neni 27

### **Organizimi i Provimit të Shtetit**

1. Provimi i Shtetit organizohet nga ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit, nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik, si edhe nga Fakulteti/Departamenti i Inxhinierisë Hidroteknike.
2. Komisioni i Provimit të Shtetit, ka këtë përbërje:
  - a) një përfaqësues nga ministria që mbulon fushën e arsimit, kryetar i komisionit;
  - b) një përfaqësues nga personeli akademik i Fakultetit/Departamentit të Inxhinierisë Hidroteknike, zëvendëskryetar i komisionit, i cili ka titullin akademik "Profesor dhe Profesor i Asocuar"/"Drejtnes kërkimesh dhe Mjeshter kërkimesh", dhe ka të paktën, 10 vjet përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë;
  - c) një përfaqësues nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik, sekretar i komisionit;
  - ç) një përfaqësues nga ministria që mbulon çështjen e punësimit, anëtar i komisionit;
  - d) një përfaqësues nga personeli akademik i Fakultetit/Departamentit të Inxhinierisë Hidroteknike, anëtar i komisionit, i cili ka titullin akademik "Profesor" dhe ka të paktën, 10 vjet përvojë punë në institucionet e arsimit të lartë.
3. Anëtarët e përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës së mësipërme, duhet të jenë me titullin “Inxhinier Hidroteknik”.
4. Anëtarët e përmendur në shkronjat "a", "c", dhe "ç" duhet të kenë eksperiencë 10 vite punë, nga të paktën 5 vite në sektorin e veprimtarisë hidroteknike publike ose private.
5. Anëtarët e Komisionit të Provimit të Shtetit do të kenë një mandat jo më shumë se dy provimesh.
6. Provimi i Shtetit organizohet një herë në vit.
7. Nëse nga personeli akademik i Fakultetit/Departamentit të Inxhinierisë



Hidroteknike nuk sigurohet asnjë person me titullin akademik "Profesor", mund të për zgjidhen edhe anëtar me gradën shkencore "Doktor" dhe me përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë, jo më pakë se 15 vjet eksperiencë.

8. Nëse nga Fakulteti/Departamenti i Inxhinierisë Hidroteknike nuk do të sigurohet asnjë anëtar, Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik zëvendëson përfaqësuesin (zëvendëskryetar në komision).

9. Rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimit të Shtetit, procedurat e mënyrat e zhvillimit të provimit, si edhe forma e shpalljes së rezultateve përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

10. Emërimi dhe largimi nga detyra e çdo përfaqësuesi në Komision bëhet me urdhër të veçantë, në bazë të propozimeve të institucioneve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, si edhe Urdhrit.

11. Urdhri përcakton, kohën e punës, shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Provimit të Shtetit, dokumentin zyrtar, shpenzimet administrative dhe metodologjin e përlogaritjes së tarifës së shërbimit.

## KREU VIII

### PAPAJTUSHMËRIA, PERSONI FIZIK/JURIDIK, FUNKSIONI PUBLIK

#### Neni 28

#### **Papajtueshmëritë**

1. Profesionistët hidroteknikë sigurohen t'i nënshtrohen zbatimit të rregullave të parashikuara në këtë ligj, si dhe akteve nënligjore të miratuara nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik.

2. Inxhinieri Hidroteknik nuk mund të ushtrojë funksion publik, të praktikojë veprimtari të një profesioni tjetër, i cili është i papajtueshëm me ushtrimin e profesionit të tij, nëse nuk ka aftësi profesionale të fituara.

3. Profesionistët hidroteknikë sigurohen që personi i cili do të kryej (shërbim) një vlerësim apo ekspertizë teknike duhet të jetë në kushte profesionale të barabarta dhe i çertifikuar/liçensuar, si edhe anasjelltas, për personat të cilët nuk janë në këto kushte, konsiderohet papajtueshmëri dhe veprimi i tyre është i pavlefshme.

4. Inxhinieri Hidroteknik nuk mund të ushtrojë profesionin e tij dhe nuk mund të jetë përfaqësues ligjor apo i punësuar, si person juridik, në qoftë se është i punësuar në institucion publik qendror dhe vendor, si edhe në sektorin Akademi në këtë të fundit nuk mund të jetë as pronar i një subjekti.

#### Neni 29

#### **Përfaqësimi i personave fizikë/juridikë**

1. Shërbimi i Inxhinierisë Hidroteknike ushtrohet nga persona fizikë/juridikë, të

çertifikuar/liçensuar sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Një ose më shumë Inxhinier Hidroteknik që ushtrojnë profesionin e tyre privatë, për të ushtruar veprimtarinë e tyre, mund të organizohen në një shoqëri tregtare, parashikuar nga legjislacioni në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

3. Vetëm inxhinieret të çertifikuar/liçensuar mund të jenë ortakë, aksionerë dhe administratorë të një shoqërie që ushtrojnë shërbimet e inxhinierisë hidroteknike.

4. Shoqëritë me kapital dhe administrim 100% të huaja, janë të detyruar të punësojnë 50% të profesionistëve vendas;

5. Çdo Shoqëri Private, Agjenci Shtetërore, Universitet (fakultetet/departamentet), duhet të regjistrohen dhe të çertifikohen/liçensohen në Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik, siç parashikohet në këtë ligj. Agjencitë shtetërore dhe universitetet, duhet të regjistrohen dhe të çertifikohen/liçensohen në Urdhër, nëse kanë si politike të tyre ushtrimin e profesionit, në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës.

Neni 30

### **Funksioni Publik**

1. Për efekt të këtij ligji, çdo përfaqësim i personave fizikë/juridikë që ushtrojnë shërbimet inxhinierike në veprimtarinë hidroteknik është një funksion i pavarur me karakter publik.

2. Inxhinieret privatë ose shoqëritë private, në ushtrimin e funksioneve të tyre, i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në Republikën e Shqipërisë, si edhe legjislacionin në fuqi që rregullon ushtrimin e profesionit të Inxhinierit Hidroteknik.

Neni 31

### **Dokumentin e identifikimit (ID)**

1. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik do të pajisë të gjithë inxhinierët hidroteknik me dokumentin e identifikimit (ID), si dhe kandidatin për marrjen e titulli që në kohën e regjistrimit në praktikën profesionale.

2. Çdo inxhinier është i detyruar të pajiset me ID-në, i cili është dokumenti zyrtar identifikues për përdorimin e titullit inxhinier hidroteknik. Ky dokument është vjetor dhe prodhohet nga Urdhri një herë në vit brenda periudhës dy mujore Janar- Shkurt.

3. Çdo inxhinier hidroteknik pajiset me ID-në, pasi të ketë paguar kuotizacionin vjetor.

4. Në rast se një inxhinier hidroteknik nuk pajiset me ID-në vjetore, nuk mund të ushtrojë profesionin dhe aktiviteti i tij konsiderohet i pezulluar, automatikisht edhe përfaqësimi i personave fizikë/juridik ku ushtron profesionin konsiderohet i pezulluar.

5. Dokumenti i identifikimit (ID) i anëtarit të Urdhrit, duhet të përmbajë të dhëna që i përkasin aftësisë teknike, kualifikime dhe kreditet (ECTS), si edhe të dhëna që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin të parashikuara në këtë ligj dhe akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

## KREU IX

### RREGJISTRI I URDHRI TË INXHINIERIT HIDROTEKNIK

#### Neni 32

##### **Përcaktimi i Rregjistrimit të Urdhrit**

1. Regjistri i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin individ dhe subjekt që ka detyrimin e regjistrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Regjistri i Urdhrit mbahet në format elektronik/dokumentare. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas këtij ligji do të regjistrohen nga Urdhri në format elektronik në dosjen përkatëse të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese:
  - a) të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, sipas këtij ligji, duke u ruajtur dhe arkivuar nga Urdhri vetëm në format elektronik;
  - b) të paraqitura nga aplikantët në format shkresor, sipas këtij ligji, konvertohen dhe ruhen nga Urdhri në format elektronik.
3. Urdhri nuk ka detyrim të mbajë e të arkivojë aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura në format shkresor, për ruajtjen e formatit shkresor përgjegjës është vetë subjekti.
4. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave, të njoftuara dhe të depozituara në Regjistrin e Urdhrit, kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar në përputhje me dispozitat e legjislativës në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Neni 33

##### **Të dhënat që regjistrohen**

Regjistri i Urdhrit duhet të përmbajë të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të individit dhe personave juridikë, çdo ndryshim në statusin dhe organizimin e subjektit, të dhëna që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si edhe të dhëna të tjera të parashikuara në këtë ligj apo me akte nënligjore të nxjerra për zbatim nga Urdhri.

#### Neni 34

##### **Detyrimi për regjistrim**

1. Detyrohen të regjistrohen në Regjistrin e Urdhrit:
  - a) Inxhinierët Hidroteknike si individë;
  - b) Shoqëritë tregtare të formës person juridik, me kapital privat dhe shtetëror të cilat detyrohen të regjistrohen paraprakisht pranë QKB-it;
  - c) Agjencitë Shtatore që kanë objekt dhe inxhinier që e ushtrojnë profesionin në fushat e

veprimtarisë Hidroteknike;  
ç) Universitetet (departamentet) që ushtrojnë profesionin në fushat e veprimtarisë Hidroteknike.

## KREU X

### EMËRTIMI I ÇERTIFIKATAVE/LIÇENCAVE

#### Neni 35

##### **Emërtimi i Çertifikatave/Liçencave**

1. Çdo person fizik/juridik, është i detyruar të kryejë shërbime, vetëm pasi të jetë pajisur me certifikatën/liçencën, për të drejtën e ushtrimit të profesionit, si edhe llojit të shërbimit.
2. “Çertifikata/Liçenca”, është dokumenti i cili prezantohet nga çdo person fizik/juridik. Dokumenti përmban emrin e personit juridik, emrin, atësinë, mbiemrin e përfaqësuesit ligjor dhe të drejtuesve teknikë, llojin e shërbimit, si dhe gjeneralitete të tjera që do të përcaktohen në rregulloret e Urdhrit, sipas përcaktimeve në këtë ligj.
3. Çdo subjekt “fizik”, “juridik”, apo individë që kërkon të kryejë një shërbim në fushën e veprimtarisë hidroteknike, detyrimisht duhet të kontraktojë për të përfituar këtë shërbim subjektet sipas profesionit hidroteknik në zbatim të plotë të këtij ligji.
4. Çdo subjekt fizik/juridik privat që ushtron aktivitetin për zbatimin e punimeve që është i pajisur me certifikatë/liçencë në “Menaxhim Projekt”, mund të pajiset edhe me certifikatën/liçencën për “Studim dhe Monitorim” dhe “Projektim”, por jo me certifikatat/liçencat: “Mbikëqyrje dhe Kolaudim” dhe “Vlerësim dhe Ekspertize Teknike”, për të shmangur konfliktin e interesit profesional.
5. Çdo subjekt fizik/juridik privat që ushtron aktivitetin me certifikatën/liçencën “Studim dhe Monitorim”, “Projektim”, “Mbikëqyrje dhe Kolaudim”, “Vlerësim dhe Ekspertize Teknike”, nuk mund të pajiset me certifikatë/liçencë në “Menaxhim Projekt”.
6. Çdo subjekt juridik shtetëror që kanë objekt dhe ushtrojnë nëpërmjet inxhinierëve hidroteknik profesionin në fushat e veprimtarisë hidroteknike, mund të pajisen vetëm me certifikatën/liçencën “Projektim” dhe me “Menaxhim Projekt”.
7. Agjencitë shtetërore që kanë objekt administrimi dhe monitorimi dhe që kryejnë shërbim nëpërmjet inxhinierëve hidroteknik në fushat e veprimtarisë hidroteknike, mund të pajisen vetëm me certifikatë/liçencë “Vlerësim dhe Ekspertize Teknike”.
8. Universitetet (Fakultetet/Departamentet) që ushtrojnë profesionin në fushat e veprimtarisë hidroteknike mund të pajisen vetëm me certifikatë/liçencë “Studimi dhe Monitorimi”.

#### Neni 36

##### **Legjitimiteti i Çertifikatave/Liçencave**

Në çdo rast personi fizik/juridik do të shoqërojë punën e tij me çertifikatën/liçencën përkatëse për ushtrimin e profesionit sipas objektit, ky dokument është i printueshëm nga sistemi i Rregjistrimit të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik. Çertifikata/Liçenca përveç gjeneraliteteve të saj mbasi të printohet duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor dhe teknik dhe vetëm atëherë do të ketë legjitimitet të plotë për t'ju drejtuar të tretëve.

#### Neni 37

#### **Pezullimi i veprimtarisë**

1. Kur një inxhinier hidroteknik që ushtron veprimtarinë e tij private, emërohet apo zgjidhet në detyra shtetërore, administrative, publike, qendrore dhe vendore me kërkesën e tij, çertifikata/liçenca për ushtrimin e veprimtarisë pezullohet për aq kohë sa zgjat detyra.
2. Për pezullimin apo rifillimin e veprimtarisë së profesionistit, personi fizik/juridik i drejtohet institucionit për të kryer shënimin përkatës në Rregjistrin e Urdhrit.
3. Inxhinieri hidroteknik mund të pezullojë me kërkesën e tij të motivuar ushtrimin e profesionit nëse do të ketë mosmarrëveshje.
4. Pezullim i përkohshëm i veprimtarisë së inxhinierit hidroteknik njëkohësisht edhe ngrirja e regjistrimit për personat fizikë/juridikë, bëhet drejtpërdrejtë nga Urdhri, në rastin kur nuk kryhet pagesa e kuotizacioneve vjetore brenda dy mujorit të parë të vitit.

### KREU XI

#### PROFESIONISTI

#### Neni 38

#### **Profesionisti**

1. Inxhinieri hidroteknik në marrëdhëniet me personin juridik që lidh kontratën e punës duhet të sigurohet që kontrata e nënshkruar mes palëve nuk është kundër interesit të individit dhe të përcaktojë qartë detyrat profesionale, si edhe të drejtat dhe detyrimet reciproke mes tyre.
2. Inxhinieri hidroteknik duhet të kërkojë garanci nga personi juridik për kryerjen në kohë të shpërblimit të tij.
3. Inxhinieri hidroteknik duhet të lidhë kontratën e punës në zbatim të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore përkatëse.
4. Inxhinieri hidroteknik do të përfitojë nga çdo punëdhënës, shpërblimin për të drejtën e përdorimit të titullit "Inxhinier Hidroteknik" në shumën jo më pakë se 10 000 lekë në muaj.
5. Inxhinieri hidroteknik do të përfitojë nga çdo punëdhënës, shpërblimin për të drejtën e përdorimit të titullit "Urdhëri Profesional Hidroteknik" të dhënë nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik, shumën jo më pakë se 25 000 mijë lekë në muaj, në këtë rast pika 4, e këtij neni nuk është e zbatueshme.
6. Pikat 4 dhe 5, të këtij neni nuk zbatohen në rastet kur inxhinieri hidroteknik nuk zbaton

pikën 4, të nenit 37, të këtij ligji.

7. Inxhinieri Hidroteknik në çdo rast që prodhon akte, studime, materiale grafike etj., duhet të nënshkruaj me firmën e tij origjinale ose me firmë elektronike në funksion të kërkesës, në rast të kundërt ky dokument nuk mund të përdoret nga të tretët pasi ky dokument humbet legjitimitetin e tij.

8. Në asnjë rast nuk mund të përdoret çertifikata/liçenca e ushtrimit të profesionit nëse nuk nënshkruhet nga vetë inxhinieri hidroteknik.

9. Inxhinieri hidroteknik gjatë ushtrimit të profesionit mund të vlerësohet dhe të zhvillojë karrierën e tij profesionale në tre nivele kualifikimi, sipas përcaktimit nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit.

10. Akti i vlerësimit i përpiluar nga QTPH, për nivelin e kualifikimit të inxhinierit hidroteknike përbën titull ekzekutiv.

11. E drejta për të kthyer në titull ekzekutiv Aktin, fillon mbas 30 ditëve nga marrja në dijeni të organi tatimor. Organi tatimor duhet të bëj ndryshimin e sistemit sipas numrit personal dhe nivelit përkatës të kualifikimit të individit. Të drejtën për të bërë kërkesë për titull ekzekutiv e ka individi edhe/ose Urdhri.

12. Këshilli i Ministrave, me propozimin të ministrit përgjegjës për financat dhe të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, përcakton pagën minimale referuese të nivelit të inxhinierit hidroteknik.

## KREU XII

### PERSONAT FIZIK/JURIDIK

#### Neni 39

#### **Marrëdhëniet me palën e kontraktuar**

1. Marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë që kryen shërbimin në veprimtarinë hidroteknike dhe palës kontraktuese rregullohen mbi bazën e kontratës së shërbimit të lidhur mes tyre. Detyrat specifike si edhe marrëdhënia midis tyre, përcaktohen në kontratën e lidhur. Kontrata lidhet në përputhje me parimet e Kodit Civil, legjislacionit në fuqi për punësimin si edhe të këtij ligji.

2. Personat fizikë/juridikë që do të kryejnë shërbimin duhet të kërkojnë garanci nga kontraktuesi për kryerjen në kohë të shpërblimit të tij.

3. Me lidhjen e kontratës së shërbimit të veprimtarisë hidroteknike, personi fizik/juridik duhet të njoftojë Urdhrin dhe të regjistrojë kontratën e shërbimit në regjistrin përkatës.

4. Me regjistrimin e kontratës, urdhri do të hartoj aktin e deklaramit të përgjegjësisë profesionale dhe njëkohësisht edhe kontratës së sigurimit të shërbimit. Urdhri do të luaj rolin e ndërmjetësit në sigurime, midis palëve dhe kompanive të sigurimit apo të bankave të nivelit të dytë, apo edhe nga vetë fondit të garancisë siguroese të urdhrin.

Autoritetet, Banka e Shqipërisë (BSH), Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) dhe Urdhri Hidroteknik përcaktojnë me rregullore llojin e kontratës, klasën e sigurimit për shërbimet në

fushën e veprimtarisë së hidroteknikës, kontratën tip të sigurimit dhe shumën e sigurimit të përgjegjësive profesionale, pa u kufizuar në kushte të tjera.

Afati i vlefshmërisë së sigurimit minimalisht do të jetë 12 muaj dhe maksimalisht 36 muaj, por jo më pak se afatet e përcaktuara në kontratën e shërbimit midis palëve. Për realizimin e këtij procesi ndiqet radha si më poshtë:

- a) Hartimi i draftit të kontratës së shërbimit midis palëve;
- b) Konfirmimi i kontratës së shërbimit nga urdhri;
- c) Rregjistrimi i Kontratës së shërbimit;
- d) Hartimi i deklaratës së përgjegjësive profesionale dhe kontratës së sigurimit të shërbimit;
- e) Deklarimi i përfundimit të shërbimit dhe përfundimit të afatit të garancisë.

5. Për fillimin e procedurave të lidhjes së kontratës së shërbimit në veprimtarinë hidroteknike dhe për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për realizimin e shërbimit, paguhet tarifat përkatëse. Tarifa përkatëse është vlera e plotë për kryerjen e të gjithë praktikës së përmendur në pikën 4, të këtij neni.

Urdhri për angazhimin administrativ në këtë proces, për një kontratë minimalisht do të aplikoj vlerat si më poshtë:

- a) Për kontrata shërbimi pa preventiv deri në vlerën 1 milion lekë do të paguhet vlera fikse prej 5,000 lekë;
- b) Për kontratë shërbimi me vlerë mbi 1 milion (+1 lekë) do të paguhet 1 % e shumës;
- c) Për kontratë për kryerjen e punimeve në ndërtim, transport, rikonstruksion, shfrytëzim apo mirëmbajtje do të paguhet vlera 2 % e shumës së preventivuar, duke përfshirë dhe përgjegjësinë pa kufizime, të shërbimeve nga specialist apo nënspecialist plotësues;
- ç. Në rastet ngurtësimi si garanci në bankë të nivelit të dytë, vlerat minimale të mësipërme do të jenë shumëfish i numrit 10.

Urdhri do të aplikoj ndryshimin e vlerave të regjistrimit të kontratave por jo më shumë se dyfishi i parashikuar në gjerat a), b) dhe c) të pikës 5, të këtij neni, për ato subjekte që do të penalizohen në vijim të përgjegjësive profesionale, nëpërmjet një sistemi pikëzimi.

#### Neni 40

##### **Marrëdhënia kontraktuese**

1. Kur marrëdhëniet e kontraktuara ndërmjet personave fizikë/juridikë dhe palës kontraktuese zgjidhen nga personi fizik/juridik që do të kryejë shërbimin, ai i kthen palës kontraktuese dokumentacionin e marrë prej tij, si edhe pjesën e shumës së marrë si parapagim për kryerjen e shërbimit.

2. Kur pala kontraktuese vendos të zgjidhë kontratën, pa shkaqe të arsyeshme, përpara përfundimit të shërbimit, personi fizik/juridik që kryen shërbimin i kthen dokumentacionin palës kontraktuese, vetëm në rast të përmbushjes së detyrimit për çdo shpenzim të kryer deri në atë çast.

3. Për rastet e parashikuar në këtë nen personi fizik/juridik që do të kryente shërbimin duhet

të njoftojë Urdhrin për identitetin e kontraktuesit, qëllimin e shërbimit si edhe për shkakun e ndërprerjes së kontratës.

#### Neni 41

### **Vlefshmëria e Shërbimit**

Aktet dhe veprimet të kryera nga personi fizik/juridik që kryen shërbimin, përpara çastit të zgjidhjes së kontratës, konsiderohen jo të vlefshme dhe procesi i mëtejshëm i fillimit të një kontrate tjetër për të njëjtin shërbim fillon nga e para.

#### Neni 42

### **Marrëdhëniet me palën kontraktuese dhe personin e tretë**

1. Pala kontraktuese ose personi i tretë detyrohet të lejojë personin fizik/juridik që kryen shërbimin në veprimtarinë hidroteknike ose personat e barazuar me të, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të prezantuar dhe sqaruar çdo çështje që lidhet me shërbimin e kryer, të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi.
2. Pala kontraktuese, personat e barazuar me të ose personi i tretë ka të drejtë të kundërshtojë kontratën e shërbimit, në gjykatë, sipas dispozitave të Kodit Civil. Në këtë rast, personi fizik/juridik që ka kryer shërbimin thirret në gjykim me cilësinë e palës së paditur. Në çdo raste për kundërshtimin e shërbimit duhet të kryhet vlerësim dhe ekspertizë teknike.
3. Kur personi fizik/juridik që kryen shërbimin në veprimtarinë hidroteknike dhe zhvillon veprimtarinë e tij në kundërshtim me këtë ligj, mban përgjegjësi për dëmin që u shkakton palëve, si dhe për dëmin ndaj të tretëve.
4. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik mund të thirret si person i tretë në gjykim.

#### Neni 43

### **Marrëdhëniet me të tretët**

1. Personat fizikë/juridikë, privatë dhe publikë, janë të detyruar që t'i japin personave fizik/juridike që kanë kryer shërbimin të gjithë informacionin e nevojshëm të kërkuar prej tij, lidhur me përdorimin e dokumentacionit dhe akteve të prodhuara prej tij dhe të përdorura nga kontraktuesi.
2. Ndaj subjekteve fizike/juridike, që fshehin në mënyrë të qëllimshme të dhënat e kërkuara nga personi fizik/juridik që ka kryer shërbimin, ky i fundit është i detyruar të bëjë kallëzim penal, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi.
3. Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë personat fizikë/juridikë që kryejnë shërbimin në veprimtarinë hidroteknike në ushtrimin të funksioneve të tyre, sipas ligjit, sa herë që kërkohet ndihmë.



## KREU XIII

### TARIFAT E SHËRBIMEVE

#### Neni 44

##### **Përcaktimi i tarifave të shërbimit**

Metodologjia e përlllogaritjes së tarifës së shërbimit, llojet e shërbimeve për kryerjen e aktivitetit në fushën e veprimtarisë hidroteknike përgatiten nga Kryesia e Urdhrit në përputhje me legjislacionin në fuqi, si edhe dispozitave që parashikohen në këtë ligj, dhe miratohet me vendim të Asamblesë Kombëtar të Urdhrit.

#### Neni 45

##### **Rastet e pakthyeshmërisë së tarifës**

1. Në rastet e mos suksesit të projektit, kur personi fizik/juridik ka kryer shërbimin në veprimtarinë hidroteknike në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme, tarifat e parapaguara janë të pakthyeshme.
2. Kur pala kontraktuese ka paguar vetëm tarifën e lidhjes së kontratës, detyrimi përmbushet në mënyrë vullnetare nga pala kontraktuese, brenda afateve ligjore, tarifa e lidhjes së kontratës është e pakthyeshme.

## KREU XIV

### DËSHMI PROFESIONALE

#### Neni 46

##### **Specialistet plotësues**

1. Individët që punojnë në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës mund të kualifikohen dhe kategorizohen për aftësitë e fituara gjatë punës së tyre në nivele vlerësimi për të cilët pajisen me dëshmi profesionale nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik.
2. Për të arritur kategorizimin punonjësi duhet të hapë librezën e dëshmisë profesionale në Urdhër sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit për kategorizimet, emërtimet dhe pozicionin në shërbimin hidroteknik të specialisteve dhe nën specialistëve.
3. Për të vërtetuar kualifikimin, dhe aftësimin e reagimit emergjent punonjësi duhet të punojë në zbatim të projekteve në fushën e veprimtarisë hidroteknike, në shoqëri që kryen aktivitetin në menaxhimin e projekteve. Akti i vlerësimit hartohet nga të tre shoqëritë respektivisht, nga shoqëria e Menaxhimit të Projekteve, shoqëria që kryen aktivitetin Mbikëqyrjes dhe Kolaudit, si edhe nga shoqëria e Vlerësimit dhe Ekspertizës Teknike.
4. Shoqëritë sipas përcaktimit në pikën 3 të këtij neni, bëjnë një raport vlerësimi për

specialistin dhe i propozojnë Urdhrit për dhënien e dëshmisë profesionale, për kategorizimin në ngritje apo ulje niveli, si edhe për aftësimin e reagimit emergjent.

5. E drejta për të kërkuar nga specialistët plotësues për kategorizim, pozicionim, llojin e shërbimit, emërtimin e ndryshimit në dëshminë profesionale është një herë në tre vite.

6. Individit mund të kërkojë në çdo kohë të heqë dorë nga dëshmia profesionale, por jo më përpara se një vite nga dokumenti paraardhës. Akti i vlerësimit bëhet i detyrueshëm në çdo 6 vite nëse nuk ka kërkesë nga vetë specialisti, për këtë rastë është detyrimi i të tre shoqërive, sipas përcaktimit në pikën 3 të këtij neni, që përkon me vitin e gjashtë.

7. Specialistët i nënshtrohen vlerësimit të sigurimit teknike, të rrishtit në punë dhe vlerësimit për aftësimin e reagimit emergjent nga shoqëri të çertifikuara/liçencuara që japin shërbim në këtë fushë, si edhe nga shoqëri që kryen aktivitetin Mbikëqyrje dhe Kolaudim ose Vlerësim dhe Ekspertizë Teknike.

8. Specialistët mund të punojnë në çdo shoqëri të regjistruar në regjistrin tregtarë dhe që kryejnë shërbime ndërtimore hidroteknike të çertifikuara/liçencuara sipas këtij ligji.

9. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik përcakton emërtimin dhe detyrat për secilin nga specialistët dhe nën specialistët plotësues dhe kualifikimin minimal.

10. Akti i vlerësimit të specialisteve dhe nën specialistes përbëjnë titull ekzekutiv. Vendimi i titullit ekzekutiv duhet të përcaktoj qartë emërtimin, kategorinë, pozicionin në grup, llojin e shërbimit, vlerën e Kreditit (ECTS) dhe që i shtohet pagës minimale bruto të specialistit dhe nën specialistit hidroteknik.

11. Të drejtën për të bërë kërkesës për titull ekzekutiv e ka individit edhe/ose Urdhri.

12. E drejta për të kthyer në titull ekzekutiv Aktin, fillon mbas 30 ditëve nga marrja në dijeni të organi tatimor. Organi tatimor duhet të bëjë ndryshimin e sistemit sipas numrit personal dhe detyrës përkatëse të individit.

13. Për zbatimin e këtij neni ngarkohen me përgjegjësi inxhinierët hidroteknik që punojnë në menaxhim të projekteve, në mbikëqyrje dhe kolaudim, në vlerësim dhe ekspertizë teknike.

14. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat dhe të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, përcakton pozicionin në grup dhe pagën minimale referuese të kategorisë të specialistëve dhe nën specialistëve plotësues në veprimtarinë hidroteknike dhe të reagimit emergjent.

## KREU XV

### EDUKIMI PROFESIONAL

#### Neni 47

#### **Qendra e Trajnimit Profesional Hidroteknik (QTPH)**

1. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik zhvillon trajnime profesionale të vazhdueshme për anëtarët e Urdhrit, nëpërmjet QTPH-s, të cilët në përfundim të këtij programi përfitojnë “Çertifikatën Profesionale të Urdhrit” dhe titullin “Urdhër Profesional Hidroteknik”.

2. Organizimi dhe funksionimi i QTPH-s përcaktohet në statutin e Urdhrit.
3. Trajnimet profesionale për titullin “Urdhër Profesional Hidroteknik” ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve. Ato kanë në themel kërkimin praktik dhe veprimtaritë krijuese që i shërbejnë veprimtarisë hidroteknike.

#### Neni 48

##### **Drejtimi i QTPH-s**

1. Qendra e Trajnimit Profesional Hidroteknik, menaxhohet nga Drejtori i QTPH-s, i cili është përgjegjës për përmbushjen e misionit për trajnimin profesional gjatë karrierës për anëtarët e Urdhrit.
2. Drejtori i QTPH-s zgjidhet nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit, me shumicë të thjeshtë votash kur për të votojnë “pro” më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm, për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, midis anëtarëve të personelit me kohë të plotë të propozuar nga Kryesia e Urdhrit.
3. Drejtori i QTPH-s duhet të jetë me titull akademik "Profesor dhe Profesor i Asocuar"/"Drejtues kërkimesh dhe Mjeshtër kërkimesh", në rastin e mos përmbushjes së këtij kriteri paraprakisht drejtuesi mund të jetë me gradën shkencore “Post Doktor” ose “Doktor” por me përvojë pune, jo më pakë se 10 vjet eksperiencë.
4. Këshilli i Përgjithshëm me propozim të Kryesisë së Urdhrit vendos miratimin e programeve të trajnimit profesional në veprimtarinë hidroteknik.

#### Neni 49

##### **Departamenti**

1. Në përbërje të QTPH-s krijohen Departamente.
2. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të edukimit dhe të punës praktike-kërkimore. Ai është përgjegjës për programet e trajnimit që ofron, si edhe monitoron proceset për dhënie e certifikatave dhe titujve sipas parashikimeve të këtij ligji.
3. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, atë praktike dhe kërkimore, në varësi të llojit të grupimit e nën grupimit të fushës së veprimtarisë hidroteknike.
4. Departamenti propozon programet e trajnimit, si edhe numrin e pjesëmarrësve në trajnim për çdo program, në përputhje me kapacitetet infrastrukture të tij, sipas standardeve të cilësisë. Departamenti propozon kriteret e pranimit të trajnuesve për secilin program studimi.

#### Neni 50

##### **Program trajnimit me karakter profesional**

1. QTPH-ja do të ofroj veprimtari mësimore dhe trajnuese, me ngarkesë përkatësisht 10 deri 30 kredite (ECTS), që finalizohen me lëshimin e çertifikatave profesionale dhe vlerësimin e krediteve përkatëse, kjo vlerë i shtohet pages minimale reference (bruto), sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Të drejtën e trajnimit në këto programe e kanë vetëm anëtarët e Urdhrit.
3. Drejtuesit e programeve duhet të kenë tituj shkencorë dhe akademik për të kryerë trajnimet profesional të anëtarëve të Urdhrit. Sistemi dual aplikohet vetëm për trajnimet për përfitimin e titullit “Urdhri Profesional Hidroteknik”.

#### Neni 51

#### **Dhënia e çertifikatës dhe titullit profesional**

1. Në përfundim të programit të trajnimit profesional të anëtarëve të Urdhrit, jepet “Çertifikata Profesionale e Urdhrit” dhe titulli “Urdhër Profesional Hidroteknik”.
2. Trajnimet profesionale për përfitimin e “Çertifikatës Profesionale të Urdhrit” zhvillohen me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme sipas përcaktimit nga Urdhri.
3. Kohëzgjatja për trajnimet për përfitimin e titullit të “Urdhërit Profesional Hidroteknik” zgjat jo më pak se një vit akademik, Kryesia e Urdhrit miraton temën përkatëse për secilin kandidatë.
4. Kandidati për përfitimin e “Urdhërit Profesional Hidroteknik”, së paku duhet të ketë botuar dy artikuj tekniko-profesional në revista shkencore të njohura me bord editorial dhe të kontrolluara paraprakisht nëpërmjetë programeve të njohura ligjërisht për antiplagjaturë.

#### Neni 52

#### **Detyrime**

1. Qendra e Trajnimit Profesional Hidroteknik do të mbajë dhe do të përditësoj të dhënat me institucionin përgjegjës së bazës së të dhënave për kërkime.
2. Qendra e Trajnimit Profesional Hidroteknik i nënshtrohet procesit të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë për akreditimin e institucionit me kërkesë të Urdhrit.

### KREU XVI

#### MASA DHE REAGIM PËR KUSHTE EMERGJENTE

#### Neni 53

#### **Kushtet e gjëndjes së emergjencës**

#### **(Emergjencat Civile)**

Urdhri nëpërmjet inxhinierëve hidroteknik dhe specialistëve dhe nënspécialistëve që ka nën mbikqyrje synon të realizojë edhe qëllimin e tij në “Emergjencat Civile” që lidhet me aftësimin për reagimin emergjent.

Neni 54

### **Parandalimi dhe njoftimi**

Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik, nëpërmjet sistemit të informimit të brendshëm, paralajmëron dhe njofton, për fenomene natyrore që mund të përbëjnë rrezik dhe risk, në mënyrë të veçantë brenda fushës së veprimtarisë së hidroteknikës. Në kuadër të parandalimit, Urdhri bashkëpunonë me institucionet e strukturave të sistemit të mbrojtjes civile dhe për këtë qëllim kryen:

- a) identifikimin e dukurive që paraqesin rrezik dhe harton regjistrin dhe hartën përkatëse;
- b) njoftimin e institucioneve, si edhe strukturat përkatëse.

Neni 55

### **Zvogëlimi i riskut nga fenomenet natyrore**

Urdhri nëpërmjet inxhinierëve hidroteknik, me qëllim zvogëlimin e riskut për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, kur shoqëria dhe ekonomia e veprimtarisë së hidroteknikës bie në gjendjen e tensioneve ekstreme prej fenomeneve të shumëllojshme natyrore, ka për detyrë të përcaktojë:

- a) Kohën për:
  - i. Parashikimin,
  - ii. Parandalimin,
  - iii. Ndikimin e fatkeqësive,
  - iv. Infrastrukturën kritike.
- b) Risqet për:
  - i. Vlerësimin e riskut,
  - ii. Zvoglimin e riskut,
  - iii. Kapacitetin përballues,
  - iv. Krizën.
- c) Planin për reagimin emergjent për:
  - i. Rehabilitimin,
  - ii. Lehtësimin dhe zbutjen,
  - iii. Rindërtimin më të mirë,
  - iv. Riskun e mbetur.

Neni 56

### **Trajnim dhe Testim për Reagimin Emergjent**

1. Urdhri i Inxhinieri Hidroteknik kryen trajnime dhe testime për reagimin ndaj emergjencave, sipas programeve dhe moduleve të miratuara më parë, si edhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile. Urdhri do të kryej trajnime dhe testime në dy nivele, të nivelit të lartë të inxhinierëve hidroteknik, si edhe të nivelit specialist dhe nënspecialist plotësues që punojnë në veprimtarinë hidroteknike, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Urdhri krijon regjistrin e eksperteve të çertifikuar për reagimin emergjent, si edhe llojin e shërbimit. Regjistri bëhet publik dhe i vihet i përditësuar në dispozicion institucioneve të sistemit të mbrojtjes civile.
3. Urdhri mund të krijojë ekipe të mbrojtjes civile, të pajisura me mjete dhe të trajnuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtij ligji.

## KREU XVII

### ANKIMI I SHËRBIMIT

#### Neni 57

#### **Kërkesë Ankimore/Ankim**

1. Kërkesat për ankim të shërbimit profesional të karakterit teknik në fushën e veprimtarisë hidroteknike, lidhur me shërbimin e kryer për “Mbikëqyrje dhe Kolaudim”, për “Vlerësim dhe Ekspertizë Teknike”, i drejtohen Urdhrit Profesional Hidroteknik.
2. Kërkesa për Ankim të Shërbimit mund të paraqiten nga:
  - a) çdo person fizik apo juridik që përfiton shërbimin dhe/ose eksperti që kryen shërbimin;
  - b) organet Drejtuese të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik;
  - c) çdo organ tjetër shtetëror, ent, universitet, prokurori, gjykatë, etj. të parashikuar me ligj;
3. Personat mund të kërkojnë:
  - a) të kthehet për rivlerësim dhe korrigjim të të metave;
  - b) të kryhet tërësisht shërbimi nga e para;
  - c) të kryhet shërbimi nga Urdhri.
4. Nëse palët nuk arrijnë të sigurojnë ose nuk paraqesin dokumentacionin e plotë për rrethana të justifikuara ose të pajustificuara Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional vendos të kryhet shërbimi nga Urdhri, dhe nëse ka element që çojnë në një vepër penale bën kallëzim në organet kompetente.
5. Nëse aktet e hartuar nga eksperti që nuk janë të ankimuara nga palët sipas pikës 2, të këtij neni dhe që nuk janë zbatuar, eksperti dhe/ose palët përfituese kanë të drejtë të dërgojnë kërkesën për konfirmim të Aktit brenda një periudhe kohore deri në 15 ditë pune nga koha e njoftimit të Aktit.

#### Neni 58

#### **Ankimi**

Personi fizik apo juridik paraqet kërkesën ankimore/ankimin lidhur me shërbimin e kryer pranë Urdhrit, kur personi fizik/juridik që ka kryer shërbimin ka vepruar në kundërshtim me normat teknike ligjore dhe referencat profesionale për kryerjen e shërbimit, që rregullojnë fushën e veprimtarisë hidroteknike të parashtruara në këtë ligj, si edhe në legjislacionin tatimor.

Eksperti i cili ka kryer shërbimin, mund të ankohet pranë Urdhrit lidhur me mos zbatimin e këtij ligji nga personi fizik/juridik që ka kryer shërbimin.

## Neni 59

### Shqyrtimi

1. Për shqyrtimin e kërkesave për Ankimim të shërbimit hidroteknik, pranë Urdhrit funksionon Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, si organizëm i gjykimit profesional. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë të miratuar nga Këshilli Kombëtar, me mandatë të hapur, përkatësisht:

- a) një përfaqësues nga Asambleja Kombëtare;
- b) një nga Kryesia e Urdhrit;
- c) një nga stafi i Urdhrit;
- ç) dy inxhinierë hidroteknikë jasht administratës së Urdhrit;
- d) Kryetari i Komisioni të Ankimit të Shërbimit Profesional zgjidhet me short për çdo çështje ankimimi nga përbërja e komisionit.

2. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisioni të Ankimit të Shërbimit Profesional përcaktohet në statutin e Urdhrit dhe në rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit.

3. Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë në veprimtarinë hidroteknike.

4. Detyra kryesore e Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional, në përmbushje të objektit të punës së tij lidhur me shqyrtimin e ankesës ndaj shërbimit të bërë sipas nënit 57, të këtij ligji, është të kontrolloj:

- a) përputhshmërinë me detyrën;
- b) rregullshmërinë e kushteve teknikë;
- c) ligjshmërinë për zhvillimin e qëndrueshëm të projektit;
- ç) sigurinë dhe shëndetin publik.

5. Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, me ekspertizë të Urdhrit ose të pavarur, mund të organizojë anketime të publikut për problemet e respektimit të të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë në veprimtarinë hidroteknike. Përfundimet që nxjerr nga studimi i anketimeve dhe nga ankesat e publikut ia raporton Urdhrit, duke sugjeruar masat për përmirësim.

6. Çdo 6 muaj Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra, në bazë të këtij neni, në një buletin të veçantë që botohet nga Urdhri.

7. Procedura administrative fillon me paraqitjen e kërkesës nga subjektet e përcaktuara në nenin 57 të këtij ligji.

8. Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, nëpërmjet njohjes së akteve dhe/ose në

seancën e parë i kërkon palëve që të zgjidhin çështjen me ndërmjetësim.

9. Komisioni i Ankimit të Shërbimi Profesional zbaton procesin e rregullt ligjor dhe nxjerr aktet administrative në bazë dhe zbatim të ligjit të Kodit të Procedurave Administrative, Kodit të Procedurave (Kodit) Civil në Republikën e Shqipërisë, normave teknike dhe referencave përkatëse të miratuara paraprakisht nga urdhri, si edhe të këtij ligji.

10. Vendimi i Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional, sipas këtij neni, ankimohet brenda 5 ditëve nga njoftimi i aktit nga Urdhri në Komisionin e Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional, sipas parashikimeve të këtij ligji.

11. Ankimi ndaj vendimit të Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional, nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional, shqyrton ankesën dhe shpall vendimin jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës për ankim. Kundër vendimit të Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

12. Çdo Akt Administrativ (shërbimi) i Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional regjistrohet në regjistër dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Urdhrit.

13. Nëse brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e aktit, i cili nuk zbatohet, atëherë bëhet kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit Ekzekutiv nga pala përfituese ose personi fizik/juridik që kryen shërbimin në fushën e veprimtarisë hidroteknike ose Urdhri.

14. Aktet Administrative (shërbimi), që përfshinë zbatimin e këtij ligji, të parashikuara në pikën 9 të këtij neni, përbën titull ekzekutiv.

15. Vendimet e Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional të Urdhrit do të ekzekutohen nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Urdhri nuk ka detyrim të parapaguajë tarifën ose tarifën për shërbimin përmbarimor.

## KREU XVIII

### ANKIMET DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

#### Neni 60

#### **Ankesa/Kërkesa**

1. Ankesat/kërkesat ndaj çdo sjelljeje ose veprimi të inxhinierëve hidroteknik apo personave fizikë/juridik si edhe specialistëve të nivelit jo inxhinier, si edhe personave jo kompetent në fushën e veprimtarisë hidroteknike, i drejtohen Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik.

2. Ankesat/kërkesat kundër personave të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, mund të paraqiten nga:

a) çdo person që përfiton shërbimin hidroteknik ose ndihmohet teknikisht dhe juridikisht prej tij;



- b) çdo person i tretë, që pretendon se është dëmtuar nga sjellja apo veprimet e inxhinierit hidroteknik apo personit fizik/juridik;
- c) organet drejtuese të Urdhrit;
- ç) çdo organ tjetër shtetëror, ent, universitet, gjykatë, etj. të parashikuar me ligj.

#### Neni 61

#### **Procedura Administrative**

1. Personat sipas përcaktimit në nenin 60, të këtij ligji, i nënshtrohen procedimit administrative kur:
  - a) ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e veprimtarisë hidroteknike në veçanti, si edhe legjislacionit tatimor.
  - b) ka vepruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierit Hidroteknik, si edhe me rregullat e tjera të përcaktuara nga Urdhrit.

#### Neni 62

#### **Shqyrtimi**

1. Për shqyrtimin e kërkesave/ankesave për procedim administrativë, pranë Urdhrit funksionon Komisioni Etikës dhe Gjykitimit Disiplinor Profesional, i cili është organ i gjykitimit disiplinor profesional. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare, përkatësisht:
  - a) Kryetari i Komisionit të Etikës dhe Gjykitimit Disiplinor Profesional;
  - b) një përfaqësues nga Asambleja Kombëtare.
  - c) një nga Kryesia e Urdhrit.
  - ç) dy inxhinierë hidroteknikë, jashtë Urdhrit.
2. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Etikës dhe Gjykitimit Disiplinor Profesional përcaktohet në statutin dhe në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierit Hidroteknik.
3. Detyrat kryesore të Komisionit të Etikës dhe Gjykitimit Disiplinor Profesional, në përmbushje të objektit të punës së tij, janë:
  - a) të shqyrtojë ankesë/kërkesat sipas fazave të verifikimit, të refuzimit dhe gjykitimit, sipas parashikimeve të këtij ligji;
  - b) mbikëqyrë zbatimin e statutit, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë, kodeve dhe rregulloreve teknike të Urdhrit, sipas përcaktimeve në këtë ligji;
  - c) kryen procedurë administrative dhe për shkeljet vendos masa disiplinore:
    - i. dënim me gjobë,
    - ii. dënim i natyrave të tjera.

ç) kryen procedurë administrative për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave/kërkesave të vendimeve të Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional të Urdhrit.

4. Procedimi administrativ përbëhet nga fazat e verifikimit, të refuzimit apo të kalimit në gjykim të kërkesës/ankesës dhe të gjykimit.

5. Procedimi administrativ fillon me paraqitjen e kërkesës/ankesës nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj.

6. Afatet e procedurës administrative të ankesës/kërkesës fillojnë nga data e mbërritjes së saj në Komisionin e Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional. Ky komision merr vendim përfundimtar brenda 30 ditë pune nga data e marrjes së ankesës/kërkesës.

7. Për çështje, të cilat kërkojnë hetime të posaçme e të specializuara, ky afat mund të zgjatet edhe 30 ditë të tjera.

8. Personit individ, fizikë/juridik që kanë dhënë shërbimin në veprimtarinë hidroteknike, ndaj të cilit është paraqitur ankesa/kërkesa, duhet të paraqesë, me shkrim, pretendimet e tij për ankesën/kërkesën brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Mosparaqitja e pretendimeve nuk përbën shkak për mos vazhdimin e procedimit disiplinor.

9. Komisioni i Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional, pasi bën verifikimet e nevojshme, dëgjon pretendimet e palëve dhe sipas rastit, vendos procedimin disiplinor, ose refuzimin e fillimit të procedimit, ky veprim bëhet brenda 10 ditëve mbas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 8 të këtij neni.

10. Ankimi ndaj vendimit të Komisionit të Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional, nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Komisioni i Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional, shqyrton ankesën dhe shpall vendimin. Kundër vendimit të Komisionit të Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional, mund të bëhet ankim jo më vonë se 15 ditë në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë.

11. Çdo vendim i Komisioni i Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional regjistrohet në regjistër dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Urdhrit.

#### Neni 63

#### **Masat administrative**

1. Komisioni i Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional heton dhe gjykon, në mbështetje të fakteve dhe provave shkresore të administruara në seancë dëgjimore me anëtarin e Urdhrit, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Kur vërteton se individi dhe personi fizik/juridik ka kryer shkelje të këtij ligji, dhe akteve nënligjore, të Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierit Hidroteknik ose ka bërë gabime teknike. Komisioni jep njëren masë për individin dhe/ose për pësonin fizik/juridik.

2. Komisioni i Etikës dhe Gjykimin Disiplinor Profesional duhet të marrë parasysh kriteret për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, përkatësisht:

a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;

b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;

- c) rëndësinë e kundërvajtjes;
- ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

#### Neni 64

#### Dënim administrativ me gjobë

1. Akteve administrative, që përshijnë zbatimin e këtij ligji, parashikojnë dënimin administrativ me gjobë.
2. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
  - a) në shkelje të nenit 6, pika 9, anëtari i urdhërit dënohet me gjobë 50 000 lekë;
  - b) në shkelje të nenit 24, pika 3, anëtari i urdhërit dënohet me gjobë nga 10 000 deri 20 000 lekë;
  - c) në shkelje të nenit 24, pika 4, pesoni juridikë dënohet me gjobë nga 100 000 deri 200 000 lekë;
  - ç) në shkelje të nenit 26, pika 1, subjekti juridik apo fizik, vendas apo i huaja që është në kundërshtim me këtë nenë, dënohet me gjobë 1 000 000 lekë, si edhe subjekti juridik që vendos dhe miraton si kriter çertifikimin e këtij lloji, dënohen me gjobë 1 000 000 lekë, çdo dokument që çertifikon sigurinë është i pavlefshëm;
  - d) në shkelje të nenit 28, pika 3, inxhinieri hidroteknik dhe personi juridik (solidarisht), për mos qenie në kushte të barabarta, dënohet me gjobë nga 100 000 deri 200 000 lekë;
  - dh) në shkelje të nenit 29, pika 4 dhe pika 5, personat juridikë dënohen me gjobë 200 000 lekë;
  - e) në shkelje të nenit 31, pika 4 inxhinieri hidroteknik dënohet me gjobë 10 000 lekë dhe personi fizik/juridik dënohet me gjobe 100 000 lekë;
  - ë) në shkelje të nenit 35, pika 3, individi, personi fizik ose/dhe juridik (administratori, ortaku janë solidarisht përgjegjës) dhe dënohet me gjobe 300 000 lekë;
  - f) në shkelje të nenit 36 përfaqësuesi ligjor dhe teknike (solidar) dënohen me gjobë 100 000 lekë, gjoba vendoset në emër të subjektit;
  - g) në shkelje të nenit 37, pika 1 dhe pika 2, inxhinieri hidroteknik dënohet me gjobë 10 000 lekë;
  - gj) në shkelje të nenit 38 subjekti fizik dhe juridik që punëson inxhinierin hidroteknik pa kontratë pune, dënohet me gjobë 200 000 lekë;
  - h) në shkelje të nenit 39, pika 1, personi fizik dhe juridik që punon pa nënshkruar kontratë shërbimi dënohet me gjobë 100 000 lekë, si edhe detyrohet të rregjistrojë kontratën sipas procedurës;
  - i) në shkelje të nenit 39, pika 3, personi fizik dhe juridik dënohet me gjobë 10 000 lekë si edhe është i detyruar të paguaj detyrimin dhe të kryej regjistrimin;
  - j) në shkelje të nenit 40, pika 3, personi fizik dhe juridik dënohet me gjobë 20 000 lekë;
  - k) në shkelje të nenit 41, personi fizikë/juridik që do të nënshkruaj një kontrate tjetër shërbimi dënohet me gjobë 500 000 lekë, në rastin së nuk do të ketë mirëkuptimin me personin

fizik/juridik që ka pasur kontratë të mëparshme dhe që ky i fundit nuk ka mbyllur detyrimet;

- l) subjekti juridik për mos dhënie informacioni dënohen me gjobë 100 000 lekë, përfshirë këtu vetëm kërkesën e bërë nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik;
  - ll) në shkelje të nenit 44, për mos zbatimin e tarifave të shërbimit, personi fizik/juridik, administrator, ortaku (solidarisht), dënohen me gjobë 500 000 lekë dhe i pezullohet aktiviteti për një periudhe kohore 2 vjet, kurse përfaqësuesit ligjor dhe ortakëve u hiqet e drejta për të qenë apo kandiduar në organet drejtuese dhe grupimit në urdhër për periudhën vijuese 3 vjeçare;
  - m) personat jo profesionist pavarësisht nga pozicioni, që punojnë në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës, që kryejnë studime, projekttime, menaxhojnë, mbikëqyrin/ kolaudojnë, vlerësojnë dhe bëjnë ekspertize teknike, apo që japin opinione publike në shkelje të këtij ligji dënohen me gjobë 500 000 lekë;
  - n) nëse gjatë kryerjes së shërbimit në veprimtarinë hidroteknike, nuk marrin në kohën e duhur vendimet për zbatimin e detyrave në shërbimin përkatës, personat fizik/juridik gjobiten në mënyrë solidare me 500 000 lekë;
  - nj) nëse inxhinieri hidroteknik do të kryej shkelje të procedurës gjatë zbatimit të detyrës së tij, personi juridik për të cilin është i punësuar, dënohet me gjobë 100 000 lekë;
  - o) personat jo kompetentë që kryejnë aktivitetin e shërbimeve në fushën e veprimtarisë hidroteknike të edukimit, mësimdhënies ose vendosen në rolin e lektorit, asistent lektor, profesorit, si edhe ata që botojnë libra teknike dënohen me gjobë 700 000 lekë.
3. Anëtar i Urdhërit gëzon të drejtën e ankimit kundër vendimit të dënimit administrative me gjobë nga Urdhëri. Anëtar i Urdhërit pasi ka shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrative, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve.

#### Neni 65

#### **Masat disiplinore për individin dhe/ose për personin fizik/juridik**

1. Shkelja e Akteve administrative, akteve nënligjore, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierit Hidroteknik, të gabimeve teknike, përbëjnë shkelje disiplinore i nënshtrohen masave disiplinore si më poshtë:
  - a) për shkelje të nenit 6, inxhinieri hidroteknik dënohet me vërejtje me paralajmërim;
  - b) për shkelje të akteve nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, inxhinieri hidroteknik dënohet me vërejtje me shkrim, nëse sasia e vërejtjeve kalon në mënyrë të përsëritur deri në 10 masa, atëherë i hiqet e drejta për të qenë, si edhe për të kandiduar në organet drejtuese dhe grupimit në Urdhër për periudhën prej 3 vite.
  - c) për shkelje të Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierit Hidroteknik, inxhinieri hidroteknik dënohet me vërejtje me shkrim, nëse sasia e vërejtjeve kalon në mënyrë të përsëritur deri në 10 masa atëherë i hiqet e drejta për ushtruar profesionin për periudhën 2 vjeçare dhe e drejta për të qenë, si edhe për të kandiduar në organet drejtuesetë Urdhrit

për periudhën vijuese 2 vjeçare.

ç) për shkelje "gabime teknike"/ka bërë gabime teknike, inxhinieri hidroteknik dënohet me vërejtje me shkrim, nëse sasia e vërejtjeve kalon në mënyre të përsëritur deri në 5 masa, atëherë i hiqet e drejta e krediteve të përfituara të asaj natyre të shkeljeve për periudhën 3 vjeçare;

d) për shkelje të Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierit Hidroteknik dhe gabime teknike me pasoja të rënda ekonomike, humane dhe mjedisore, inxhinieri hidroteknik përjashtohet nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik për një periudhë deri në 5 vjet, por jo më të vogël se periudha e dënimit penal të tij.

2. Masat e mësipërme vlerësohen të shlyera, në qoftë se brenda 1 viti nga dita e dhënies së tyre, për shkronjat "a", "b", të këtij neni, dhe brenda 3 vjetëve për shkronjën "c" nëse nuk është marrë ndonjë masë tjetër ndaj inxhinierit hidroteknik.

3. Përveç masave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si masë plotësuese, komisioni ka edhe të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese, të barabarta me 20 kredite.

4. Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional mund të vendosi masë disiplinore me vërejtje me shkrim, nëse do të konsiderojë ndonjë kërkesë apo ankesë që nuk ka mbështetje për dëmin në nenet e sipërpërmendura, që lidhet dhe arsyetohet në zbatim të këtij ligji apo akteve nënligjore në fuqi.

Neni 66

#### **Njoftimi dhe afatet e njoftimit**

Për njoftimin dhe afatet e njoftimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative zbatohen dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 67

#### **Titull Ekzekutiv**

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative bëhet titull ekzekutiv në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar të kundërvajtjes në rrugë administrative.

2. Nëse brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit për kundërvajtjen administrative nuk shlyhen detyrimet monetare atëherë bëhet kërkesa për nxjerrën e Urdhrit Ekzekutiv.

3. Akteve administrative, që përshijnë zbatimin e këtij ligji, të parashikuara në nenin 64, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor.

4. Mbi detyrimin monetar të pa paguar do të llogariten interesa në vlerën 1 % në ditë vonës, përlllogaritja e interesit fillon mbas 30 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit për kundërvajtjen administrative, llogaritja e interesave bëhet drejtpërdrejt nga përmbaruesi gjyqësor.

## Neni 68

### **Ankimi në rrugë gjyqësore**

1. Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim me gjobë, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.
2. Në rastin e shqyrtimit në rrugë gjyqësore të vendimit për kundërvajtjen administrative, që ka parashikuar dënim me gjobë, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit dhe kur gjykon se organi administrativ ka keqinterpretuar ligjin, ka tejkaluar apo ka shpërdoruar kompetencat, vendos edhe në lidhje me dënimin.
3. Barra e provës në kundërvajtjen administrative bie mbi organin që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.

## KREU XIX

### **PRONËSIA E PATJETËRSUESHME**

## Neni 69

### **Pronësia e patjetërsueshme**

1. Asnjë nga anëtarët e Urdhrit nuk do të ketë kërkesë personale mbi pasurinë e Urdhrit dhe asnjë pjesë e kësaj pasurie nuk do të paguhet ose transferohet tek asnjë person i cili në çdo kohë është ose ka qenë anëtar i Urdhrit.
2. Shpërblimi në këmbim të çdo shërbimi të dhënë në Urdhër ose rimbursimi i shpenzimeve të njoftura në mirëbesim likujdohen sipas **rregullores së brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, sipas dispozitave në këtë ligj.** Likujdimi i detyrimeve financiare sipas kësaj pike, nuk duhet të parandaloj/pengoj/ndaloj dhënien e shpërblimeve ose bursave për anëtarët, si edhe pagesën e interesit për paratë e huazuara nga institucioni.
3. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik është pronë publike dhe e patjetërsueshme.

## KREU XX

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

## Neni 70

### **Akte nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 38, pika 12 dhe 46, pika 14, të këtij ligji.

2. Ngarkohet, ministri përgjegjës për arsimin, si edhe ministri përgjegjës për punësimin, në zbatim të neneve 26 dhe 27, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë urdhrin e parë për kryerjen e Provimit të Shtetit.

Neni 71

#### **Organizimi i zgjedhjeve të para**

1. Ministri përgjegjës për **Infrastrukturën dhe Energjinë**, me urdhër, ngre një komision të përkohshëm, i cili organizonë zgjedhjet e para të urdhrin, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Me zgjedhjen e Asamblesë Kombëtare të Urdhrit, komisioni i përkohshëm pushon së ekzistuari.

Neni 72

#### **Dispozita kalimtare për individët që ushtrojnë profesionin e inxhinierit hidroteknik në veprimtarinë hidroteknike**

1. Individët që, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e inxhinierit hidroteknik dhe kanë të dokumentuar formimin dhe kualifikimin profesional për ushtrimin e këtij profesioni, sipas nenit 12, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, u lind e drejta e menjëhershme e anëtarësimit në Urdhër.
2. Personat fizik/juridik që, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e inxhinierit hidroteknik në fushën e veprimtarisë hidroteknike, mund të vazhdojnë ushtrimin e profesionit të hidroteknikut për një afat të caktuar nga Urdhri, por janë të detyruar të ndjekin programe të formimit dhe kualifikimit/rikualifikimit profesional, të përshtatshme për ushtrimin e profesionit të tyre brenda periudhës 2 vjeçare.
3. Për ata individ, sipas dispozitave të këtij ligji, të kryejnë provimin e shtetit, brenda një periudhe vijuese 3 vite, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 73

#### **Shfuqizime**

Çdo dispozitë e akteve ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 74

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hy në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R**

**LINDITA NIKOLLA**